



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.163/1

22 tetor

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Marrëveshjet e vendimit të KM
nr.1363, datë 17.10.2008

Marrëveshje e shitjes së energjisë lidhur me një projekt të ri
hidrocentrali në Ashtë, Republika e Shqipërisë ndërmjet
Österreichische Elektrizitäts- und Energiewirtschafts-Unternehmen
dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare 3

Marrëveshje për koordinimin e kaskadës së lumit Drin
ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare dhe
Österreichische Elektrizitäts- und Energiewirtschafts-Unternehmen . 25

MARRËVESHJE
E
SHITJES SË ENERGJISË

LIDHUR ME NJË PROJEKT TË RI
HIDROÇENTRALI NË ASHTË,
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

NDËRMJET

ÖSTERREICHISCHE ELEKTRIZITÄTSËIRTSCHAFTS -
AKTIENGESELLSCHAFT

DHE

KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE

30 SHTATOR 2008

TABELA E PËRMBAJTJES

1.	PËRKUFIZMET DHE INTERPRETIMI.....	<u>6</u>
1.1	Përkufizimet	<u>6</u>
1.2	Interpretimi	<u>11</u>
2.	SHITJA DHE BLERJA E PRODHIMIT NETO TË ENERGJISË ELEKTRIKE	<u>13</u>
2.1	Sigurimi i Prodhimit Neto të Energjisë.....	<u>13</u>
2.2	Dispozitat për dispecerimin e Prodhimit të Deklaruar	<u>14</u>
2.3	Respektimi i Kufijve Teknikë	<u>14</u>
2.4	Shërbimet e Nevojshme.....	<u>14</u>
2.5	Kompensimi për Shmangien nga Prodhimi i Deklaruar.....	<u>15</u>
3.	ÇMIMI PËR NJËSI, PAGESA DHE FATURIMI.....	<u>15</u>
3.1	Pagesat e Blerësit.....	<u>15</u>
3.2	Grafiku i Faturimit dhe i Pagesës	<u>16</u>
3.3	Kreditimi i Shtuar – Garancia Bankare.....	<u>17</u>
4.	SHFRYTËZIMI DHE FUNKSIONALITETI I HIDROCENTRALIT	<u>18</u>
4.1	MBAJTJA E RAPORTEVE TË SHFRYTËZIMIT	<u>18</u>
4.2	Funksionaliteti i Hidrocentralit për Prodhimin e Dispeceruar.....	<u>18</u>
4.3	Bilancet dhe Raportet	<u>18</u>
5.	MATJA.....	<u>18</u>
5.1	Sistemi i Matjes.....	<u>18</u>
5.2	Rregullimi i Matësve të Pasaktë	<u>20</u>
5.3	Kodi i Matjes	<u>20</u>
6.	NDËRPRERJET E PLANIFIKUARA DHE TË DETYRUARA TË ENERGJISË ELEKTRIKE	<u>20</u>
6.1	Ndërprerjet e Planifikuara për Remontet Kryesore	<u>21</u>
6.2	Ndërprerjet e Detyruara.....	<u>21</u>
6.3	Njoftim mbi Ndryshimet në Gjendjen e Funksionimit.	<u>21</u>
7.	FORCA MADHORE DHE SHKARKIMI I TËRTHORTË I PËRGJEGJËSISË SË PALËVE.....	<u>21</u>
7.1	Forca Madhore.....	<u>21</u>
7.2	Shkarkimi i Përgjegjësisë së Palëve në Lidhje me Marrëveshjen e Koncesionit – Moskompensim i Dyfishtë	<u>22</u>
8.	AFATI DHE ZGJIDHJA.....	<u>23</u>
8.1	Hyrja në Fuqi dhe Afati i kësaj Marrëveshjeje	<u>23</u>

8.2	Rastet e Mospërbushjes së Marrëveshjes nga Shitësi.....	25
8.3	Rastet e Mospërbushjes së Marrëveshjes nga Blerësi	26
8.4	Pasojat e Zgjidhjes – Zgjidhja e Tërthortë me Miratim.....	26
9.	SIGURITË DHE GARANCITË	28
9.1	Siguritë dhe Garancitë e Shitësit	28
9.2	Siguritë dhe Garancitë e Blerësit	29
10.	TAKSAT.....	30
10.1	Taksat e Zbatueshme ndaj Shitësit	30
10.2	Taksat e Zbatueshme ndaj Blerësit.....	30
11.	ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE	30
11.1	Zgjidhja me Pajtim	30
11.2	Eksperti Teknik dhe Ekonomik	30
11.3	Arbitrazhi.....	31
12.	DISPOZITA TË NDRYSHME	31
12.1	Transferimi i të Drejtave – Garancia	31
12.2	Ligjet e Zbatueshme	32
12.3	Përgjegjshmëria – Dëmtshpërblimi.....	32
12.4	Shlyerjet/Kompensimet dhe Kundërpretendimet	32
12.5	Gjuha	32
12.6	Ligji i Zbatuar.....	33
12.7	Njoftimet	33
12.8	Vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje	34
12.9	Garancia e Mëtejshme	34
12.10	Marrëveshja e Plotë	34
12.11	Mos-Heqje dorë	34
	SHTOJCA I KËRKESAT MINIMALE TË SISTEMIT TË MATJES	35
	SHTOJCA II PRODHIMI I DEKLARUAR.....	38
	SHTOJCA III FORMA E GARANCISË BANKARE TË BLERËSIT	39

LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca I: Kërkesat Minimale të Sistemit të Matjes

Shtojca II: Prodhimi i Deklaruar

Shtojca III: Forma e Garancisë Bankare të Blerësit

Shtojca IV: Detyrimi i Taksës së Jashtëzakonshme

Kjo Marrëveshje e Shitjes së Energjisë lidhur me një hidrocentral të ri në Ashtë, Republika e Shqipërisë (“Marrëveshja”), lidhet më 30 Shtator 2008, ndërmjet:

- (A) KORPORATËS ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (KESH), një shoqëri aksionare e krijuar në Shqipëri me Vendimin Nr. 12728 datë 6 Nëntor 1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shqipëri, me seli në adresën Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar në këtë marrëveshje nga Z. Gjergji Bojaxhi, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm (“KESH” ose “Blerësi”); dhe
- (B) Österreichische Elektrizitätswirtschafts – Aktiengesellschaft, një Shoqëri Aksionare e krijuar sipas ligjeve të Austrisë, e regjistruar në regjistrin e shoqërive të Gjykatës Tregtare të Vjenës me nr. regjistrimi FN 76023z, me seli në Vjenë dhe adresë Am Hof 6A. 1011 Vjenë, Austri (“Verbund” ose “Shitësi”).

Secili prej tyre, si Blerësi dhe Shitësi do të referohen individualisht si “Pala” dhe bashkërisht “Palët”.

DEKLARIM HYRËS

DUKE QENË SE:

Kjo Marrëveshje lidhet në datën e caktuar më sipër nga Verbund, i cili:

do të krijojë Shoqërinë e Projektit në përputhje me Nenin 3.1. (a) (i) të Marrëveshjes së Koncesionit, dhe

do ta transferojë këtë Marrëveshje tek Shoqëria e Projektit sa më shpejt të jetë praktikisht e mundur pas nënshkrimit të saj me kusht, megjithatë, që pas këtij transferimi, Verbund dhe Shoqëria e Projektit do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe individualisht, sipas kësaj Marrëveshjeje.

Blerësi me anë të kësaj Marrëveshjeje miraton në mënyrë të shprehur transferimin e përshkruar në pikën (A) (ii) e Deklarimit Hyrës.

E drejta e Shitësit për të furnizuar Prodhimin e Përkohshëm Neto të Energjisë Elektrike dhe Prodhimin Neto të Energjisë Elektrike tek Blerësi si dhe për të mbledhur Pagesat e Blerësit nga Blerësi në përputhje me afatet dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje përbën një të Drejtë thelbësore Koncesionare sipas Nenit 2.1. të Marrëveshjes së Koncesionit.

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi dhe do të ketë efekt në datën e parashikuar në Nenin 8.1. këtu më poshtë dhe do të zbatohet në përputhje me Kodin e Transmetimit dhe Rregullat e Tregut.

Shitësi dëshiron dhe ka si qëllim t'i shesë Blerësit dhe Blerësi dëshiron dhe ka si qëllim të blejë nga Shitësi Prodhimin Neto të Përkohshëm të Energjisë Elektrike dhe Prodhimin Neto të Energjisë Elektrike të Hidrocentralit sipas afateve dhe kushteve të parashikuara në këtë marrëveshje.

PRANDAJ, duke pasur parasysh zotimet detyruese të parashikuara këtu dhe të cilat konsiderohen të mjaftueshme në këtë Marrëveshje, Palët bien dakord si më poshtë:

1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI

1.1. Përkufizimet

Të gjitha fjalët me shkronja të mëdha që nuk janë përkufizuar ndryshe në këtë Marrëveshje, do të kenë kuptimin që u jepet atyre në Marrëveshjen e Koncesionit.

Kurdoherë që të përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë dhe Shtojcat e saj), përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, dhe përveç kur janë përkufizuar ndryshe në Marrëveshjen e Koncesionit, fjalët më poshtë do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

“Palë e Cenuar” do të ketë kuptimin e parashikuar në Nenin 7.1. këtu më poshtë (*Forca Madhore*);

“Kosto Përmbledhëse e Taksave” do të thotë shuma e të gjitha Taksave të zbatueshme, në lidhje me Projektin, ndaj Koncesionarit dhe/ose Shitësit, Hidrocentralit dhe aseteve të tjera të Shitësit dhe/ose të Koncesionarit, në çdo rast deri në masën që nuk është marrë përsipër për t'u paguar ose rimbursuar nga Autoriteti Kontraktues sipas Marrëveshjes së Koncesionit;

“Marrëveshje” do të thotë kjo Marrëveshje e Shitjes së Energjisë Elektrike, bashkë me të gjitha Shtojcat bashkëngjitur, me gjithë ndryshimet që mund të pësojë, sipas kushteve të saj, ndërmjet Blerësit dhe Shitësit;

“Autorizime” do të thotë çdo miratim, leje, licencë (duke përfshirë Licencat), autorizim, aprovim ose çertifikatë, nxjerrja ose ripërtëritja e të cilave është përgjegjësi e çdo Organi Shtetëror dhe që kërkohet në lidhje me këtë Marrëveshje;

“Pretendime” do të thotë, për sa i përket çdo Pale, çdo dhe të gjitha paditë, sanksionet, procedimet ligjore, pretendimet, vlerësimet, gjykimet, dëmet, gjobat, detyrimet, kërkesat, kostot, shpenzimet e arsyeshme operative (kesh) të çfarëdolloji (duke përfshirë tarifa të arsyeshme ligjore) dhe humbjet që kanë ndodhur kundrejt kësaj Pale ose janë pësuar nga kjo Palë, por duke përjashtuar ndonjë përfitim të humbur ose dëme të tjera specifike, të parëndësishme, jo të drejtpërdrejta, ndëshkuese ose vijuese;

“Marrëveshja e Koncesionit” do të thotë Marrëveshja e Koncesionit për projektimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, funksionimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Hidrocentralit, e lidhur në të njëjtën datë me këtë Marrëveshje, ndërmjet METE si Autoriteti Kontraktues dhe Shitësit në cilësinë e Koncesionarit;

“Prodhim i Deklaruar” ka kuptimin e parashikuar në Nenin 2.1. këtu më poshtë (*Sigurimi i Prodhimit Neto të Energjisë Elektrike*)

“Pika e Lëvrimit” gjendet në pikën e miratuar nga Koncesionari dhe OST në anën e tensionit të lartë (në nivelin 110 kV) të transformatorit rritës ose të nënstacionit në pronësi të Koncesionarit dhe të pajisjeve të rrjetit të transmetimit në pronësi (ose që do të jenë në pronësi) të OST në përputhje me Ligjin “Mbi Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe rregulloret përkatëse, dhe nëpërmjet të cilës prodhimi i energjisë lëvrohet nga rrjeti i transmetimit të Koncesionarit në atë të OST;

“Dispecerim” ka kuptimin e parashikuar në Kodin e Transmetimit;

“Udhëzim i Dispecerimit” do të thotë një Udhëzim i lëshuar nga OST për Shitësin në përputhje me (a) Kodin e Transmetimit dhe Rregullat e Tregut, dhe (b) Praktikat e Industrisë së Mirë;

“Prodhimi i dispeceruar” ka kuptimin e parashikuar në Nenin 2.2.;

“Hyrja në Fuqi” ka kuptimin e parashikuar në Nenin 8.1 më poshtë:

“Detyrim Takse të Jashtëzakonshme” ose “DTJ” do të thotë çdo shumë që kalon 125% të Kostos faktike Përmbledhëse të Taksave Vjetore të Shitësit

dhe/ose të Koncesionarit, krahasuar me Koston Përmbledhëse të Taksave të llogaritur paraprakisht në Datën e Hyrjes në Fuqi, që mund të rezultojë nga

i) një amendament i çdo Ligji i cili ka ekzistuar në Datën e Hyrjes në Fuqi, ose

ii) shpallja e një Ligji të ri i cili nuk ka qenë i zbatueshëm në Datën e Hyrjes në Fuqi,

e cila zbatohet ndaj Koncesionarit dhe/ose Shitësit, Hidrocentralit dhe aseteve të tjera të Shitësit dhe/ose Koncesionarit në lidhje me Projektin.

DTJ do të llogaritet nga Shitësi çdo vit duke u bazuar në bilancet vjetore të audituara të Shitësit dhe Koncesionarit, për vitin e mëparshëm.

“Rast i Forcës Madhore” ka kuptimin e parashikuar në Nenin 7.1. më poshtë;

“Ndërprerje e Detyruar” do të thotë një ndërprerje e të gjithë ose e një pjese të energjisë së hidrocentralit, e kryer nga Shitësi pa i dërguar OST një njoftim paraprak prej gjashtë (6) orësh ose çdo ndërprerje që kalon maksimumin e lejuar të ndërprerjeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje;

“Entitet Shtetëror” do të thotë (i) Qeveria e Republikës së Shqipërisë, ose çdo ministri, departament apo nëndarje politike a ushtarake e saj; dhe (ii) çdo gjykatë ose instancë gjyqësore ose çdo entitet tjetër qeveritar, instrument, agjenci ose autoritet nën kontrollin e Republikës së Shqipërisë, ose çdo ministri, departament ose nëndarje politike e saj, dhe që e ushtrojnë juridiksionin, sipas Ligjeve të Republikës së Shqipërisë mbi Koncesionarin, ose çdo autoritet i pavarur rregullator (duke përfshirë dhe Rregullatorin), në çdo rast, brenda Republikës së Shqipërisë.

“Kodi i Transmetimit” ose “Kodi i Sistemit të Transmetimit” do të thotë rregullat e përgatitura dhe të miratuara nga ERE që rregullojnë funksionimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë operimin, kodin e shpërndarjes dhe kodin e lidhjes;

“Prodhim Neto i Përkohshëm i Energjisë Elektrike” do të thotë Prodhim Neto i Energjisë Elektrike i deklaruar nga Shitësi i cili është prodhuar dhe i është lëvruar Blerësit përpara Përfundimit Final në lidhje me testimin dhe komisionimin e Hidrocentralit sipas Marrëveshjes së Koncesionit; për të hequr çdo dyshim, energjia elektrike e prodhuar nga Shitësi dhe e përdorur për qëllimet e veta nuk përbën Prodhim Neto të Energjisë Elektrike ose Prodhim Neto të Përkohshëm të Energjisë Elektrike;

“Pagesa për Prodhimin Neto të Përkohshëm të Energjisë Elektrike” do të thotë pagesa që duhet të bëhet nga Blerësi si shpërblim për Prodhimin Neto të Përkohshëm të Energjisë Elektrike;

“Norma e Interesit të Pagesës së Vonuar” do të thotë tre muaj EURIBOR + 300 bps;

“Ligj” do të thotë çdo statut i zbatueshëm kombëtar ose lokal, urdhëresë, dekret ose ligj tjetër (duke përfshirë Ligjin mbi Mjedisin), rregullore ose akt nënligjor ose çdo rregull, kod ose udhëzim, licencë, miratim, leje, autorizim ose aprovim tjetër i Republikës së Shqipërisë ose i çdo entiteti ose nëndarje të saj ose të ndonjë personi të parashikuar me ligj (qoftë ose jo i pavarur) i cili ka juridiksionin e duhur, në masën e publikuar dhe që disponohet publikisht, dhe që është subjekt zbatimi i vendimeve të gjykatave të ndryshme dhe të kolegjeve gjyqësore të Republikës së Shqipërisë, të vendimeve dhe urdhrave ekzekutive, të qarkoreve të departamenteve, si dhe prononcimet dhe interpretimet e organeve zyrtare të Republikës së Shqipërisë, që kanë juridiksion mbi çështjen në fjalë; siç mund të amendohen, ndryshohen, apo shfuqizohen kohë pas kohe.

“Rregullat e Tregut” do të thotë rregullat e funksionimit të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike së bashku me të drejtat dhe detyrimet e detyrueshme për pjesëmarrësit në treg gjatë kryerjes së transaksioneve në tregun e Energjisë Elektrike, siç është miratuar nga ERE;

“Pasoje thelbësisht e dëmshme” do të thotë çdo pasojë thelbësisht në kundërshtim me (i) aftësinë e Shitësit për të respektuar dhe ushtruar çdo të drejtë dhe detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje në rrethana normale, dhe/ose (ii) ligjshmërinë, vlefshmërinë, natyrën detyruese ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje;

“Kodi i Matjes” do të thotë Kodi i përgatitur nga Komisioni i Kodit të Matjes së Energjisë Elektrike dhe i miratuar nga Rregullatori, i cili përcakton kërkesat teknike minimale për instalimin dhe përdorimin e sistemit matës të energjisë elektrike;

“METE” do të thotë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Republikës së Shqipërisë, e cila ka lidhur Marrëveshjen e Koncesionit në cilësinë e saj si Autoriteti Kontraktues;

“Prodhimi Neto i Energjisë Elektrike” do të thotë e gjithë energjia neto elektrike e shprehur në KWh/h dhe kWh e lëvruar nga Shitësi tek Pika e Lëvritimit në çdo moment gjatë afatit të Marrëveshjes, në përputhje me këtë Marrëveshje (përfshirë këtu Prodhimin Neto të Përkohshëm të Energjisë Elektrike);

“Pagesa për Prodhimin Neto të Energjisë Elektrike” do të thotë pagesat që duhet të bëhen nga Blerësi si shpërblim për Prodhimin Neto të Energjisë Elektrike;

“Pala e Pacenuar” ka kuptimin e parashikuar në Nenin 7.1. këtu më poshtë (*Forca Madhore*)

“Faza e Shfrytëzimit” do të thotë periudha e kohës që kalon që nga Data e Përfundimit Faktik të Punimeve deri në përfundimin e Afatit të kësaj Marrëveshjeje;

“OST” do të thotë shoqëria OST Sh.A. e cila është operatori i autorizuar i sistemit të transmetimit për sistemin elektroenergjitik kombëtar të Shqipërisë

“Data e Pagesës” ka kuptimin e parashikuar në Nenin 3.2. këtu më poshtë (*Grafiku i Pagesës dhe i Faturimit*)

“Ndërprerjet e Planifikuara për Remontet Kryesore” do të thotë ndërprerje të lejuara për t’i dhënë mundësi Shitësit të përmbushë kërkesat e mirëmbajtjes vjetore në lidhje me çdo njësi gjenerimi në përputhje me rekomandimet e prodhuesve përkatës;

“Blerës” do të thotë KESH (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare), Shoqëri Shqiptare e gjenerimit të energjisë elektrike, ose çdo entitet apo shoqëri tjetër publike siç mund të jetë përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues, me kusht që (i) kredibiliteti i këtij entiteti ose kësaj shoqërie të jetë të paktën i barazvlefshëm me atë të KESH në datën e kësaj marrëveshjeje, dhe (ii) ky entitet ose kjo shoqëri të sigurojë nxjerrjen e një garancie bankare të rradhës së parë, me kushte, të paktën po aq të favorshme sa ato të Garancisë Bankare të Blerësit;

“Garancia Bankare e Blerësit” ka kuptimin e parashikuar në Nenin 3.3. (*Kreditim i Shtuar – Garancia Bankare*) këtu më poshtë;

“Pagesat e Blerësit” do të thotë shumat e paguar nga Blerësi te Shitësi, e cila do të përfshijë Pagesat për Prodhimin Neto të Përkohshëm të Energjisë Elektrike dhe Pagesat për Prodhimin Neto të Energjisë Elektrike;

“Rregullator” do të thotë ERE (Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike) (Albanian Electricity Regulatory Authority) ose çdo rregullator tjetër i industrisë së energjisë elektrike, apo departament rregullator, agjenci ose autoritet tjetër i Republikës së Shqipërisë apo çdo nëndarje e tyre e krijuar në bazë të Ligjit nr. 9072 datë 22.05.2003 “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*” apo në bazë të çdo akti tjetër ligjor i cili e vesh organin e krijuar prej tij me autoritetin për të miratuar tarifën dhe çmimet e energjisë elektrike, për të monitoruar aktivitetet e licencuara, dhe për të zgjidhur

mosmarrëveshjet ndërmjet të licencuarve dhe ndërmjet të licencuarve dhe klientëve;

“Shitës” fillimisht do të thotë Verbund dhe pas transferimit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me Pikën (A) të Deklarimit Hyrës, do të thotë Shoqëria e Projektit;

“Ndërprerje për Mirëmbajtje të Njoftuara në Kohë të Shkurtër” do të thotë çdo riparim i nevojshëm i cili nuk mund të ishte planifikuar në një program të caktuar më parë, por që kërkohet të kryhet për të qenë në përputhje me Praktikën e Industrisë së Mirë;

“Taksë” do të thotë çdo taksë, detyrim, tatim, tarifë, pagesë, taksë doganore ose tarifë e çdo lloji, e ngarkuar, e vënë, ose e mbledhur, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga çdo Entitet Shtetëror sipas Ligjit, duke përfshirë çdo taksë mallrash dhe shërbimesh, taksë shitjeje, tarifë pullash a vulash, tarifë importi, taksë mbi të ardhurat (qoftë mbi të ardhurat, dividendët, pagesat e interesit, tarifat, mbi qiratë e pajisjeve ose të tjera), taksë mbi huatë në monedhë të huaj ose mbi transaksionet e këmbimit me jashtë, taksë akcize, taksë mbi pronësinë, tarifë regjistrimi ose licence, duke përfshirë çdo interes, sanksion ose shtesa të tjera mbi to.

“Eksperti Teknik dhe Ekonomik” do të thotë eksperti i caktuar bashkërisht nga të dyja Palët për qëllime pajtimi në përputhje me Nenin 11.2 (*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*).

“Afati” do të thotë afati i kësaj Marrëveshjeje në përputhje me Nenin 8.1 këtu më poshtë (*Hyrja në Fuqi dhe Afati i kësaj Marrëveshjeje*);

“Njoftimi për Zgjidhje” do të thotë, në lidhje me Shitësin ose Blerësin, sipas rastit, një njoftim nga njëra Palë te Pala tjetër ku deklarohet se kjo Marrëveshje do të zgjidhet në vijim (i) të një Rasti Mospërmbushjeje nga Shitësi ose të një Rasti Mospërmbushjeje nga Blerësi, sipas rastit, i cili nuk është përmbushur brenda një kuadri kohor të caktuar të parashikuar në këtë Marrëveshje, (ii) të një Rasti të Forcës Madhore të Tejzgjatur, njoftim i cili do të specifikojë shkakun e zgjidhjes dhe datën e zgjidhjes faktike të kësaj Marrëveshjeje, e cila do të jetë jo më parë se tridhjetë (30) ditë pas këtij njoftimi.

Interpretimi

Përveç kur nuk kërkohet ndryshe në këtë Marrëveshjeje:

fjalët në secilën gjini do të përfshijnë edhe gjininë tjetër;

fjalët që përdorin numrin njëjës ose shumës përfshijnë gjithashtu respektivisht numrin shumës ose njëjës;

termat “të kësaj”, “këtu”, “nëpërmjet kësaj ose nga kjo”, “në këtë” dhe fjalë të ngjashme i referohen Marrëveshjes në tërësi dhe jo ndonjë Neni, Paragrafi, Tabele, Bashkëlidhje ose Grafiku apo ndonjë nëndarjeje tjetër të kësaj Marrëveshjeje;

Deklarimi Hyrës dhe Shtojcat, Tabelat dhe Bashkëlidhjet tek kjo Marrëveshjeje do të përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje dhe referencat në Shtojcat, Tabelat dhe Bashkëlidhjet do të jenë referenca në Shtojcat, Tabelat dhe Bashkëlidhjet tek kjo Marrëveshje, përveç kur Palët bien dakord ndryshe.

referencat në ndonjë akt përfshijnë çdo ndryshim ose ri-nxjerrje të atij akti, si dhe çdo rregull ose rregullore të nxjerrë në zbatim të këtij akti; dhe referencë në një ligj do të thotë referencë në një ligj të tillë, siç mund të jetë ndryshuar ose rinxjerrë a ribërë;

fjalët “përfshin” ose “duke përfshirë” do të konsiderohet se pasohen nga “pa kufizim” ose “duke mos u kufizuar në”, edhe nëse ato ndiqen ose jo nga fraza ose fjalë të tilla të ngjashme;

referencat në “këtë Marrëveshje” ose “këtë Marrëveshje Koncesioni” ose çdo marrëveshje ose dokument tjetër do të interpretohen si referenca në këtë marrëveshje ose dokument, i ndryshuar, modifikuar ose shtuar, dhe që janë në fuqi nga koha në kohë, si dhe do të përfshijnë referencën në çdo dokument që e ndryshon, modifikon ose e shton atë, ose që është lidhur a nënshkruar, bërë ose dhënë në zbatim ose në përputhje me kushtet e saj;

sa herë që kjo Marrëveshje i referohet një numri “ditësh” ky numër do t’i referohet ditëve kalendarike përveç kur specifikohen si Ditë Pune;

çdo referencë në një “muaj” ose “vit” do të interpretohet si referencë në një muaj kalendarik ose vit kalendarik;

çdo fjalë, term, frazë dhe shkurtime që fillon me shkronjë të madhe e përdorur specifikisht në ndonjë Shtojcë, Bashkëlidhje a Dokument tjetër Bashkëngjitur do të ketë kuptimin e përcaktuar në këtë Shtojcë ose Bashkëlidhje, sipas rastit;

në rast mospërputhjeje midis çdo fjale me germë të madhe, termi të përcaktuar, fraze ose shkurtime të parashikuara në Nenin 1.1 dhe çdo dispozite, fjale me germë të madhe, termi, fraze ose shkurtime të parashikuar gjatë në këtë Marrëveshje, Shtojcë, Bashkëlidhje ose në një Dokument tjetër Bashkëngjitur tek çdo Bashkëlidhje, kuptimi i dhënë aty do të ketë përparësi ndaj kuptimit të dhënë në Nenin 1.1, përveç kur konteksti i kësaj Marrëveshjeje e kërkon ndryshe;

në rast papajtueshmërie ndërmjet tërësisë së kësaj Marrëveshjeje me Shtojcat dhe Bashkëlidhjet, Palët do të përpiqen, që fillimisht të zgjidhin papajtueshmërinë nëpërmjet leximit të kësaj Marrëveshjeje në tërësi, dhe do të zbatohet dispozita që e trajton në mënyrë më specifike këtë çështje. Nëse papajtueshmëria vazhdon të ekzistojë me gjithë përpjekjet e Palëve për ta zgjidhur me mirëbesim atë siç parashikohet në fjalinë paraardhëse, për zgjidhjen e saj do të zbatohen dispozitat e tërë kësaj Marrëveshjeje; dhe

titujt e Neneve dhe të Kapitujve në këtë Marrëveshje dhe Tabela e Përmbajtjes janë bërë vetëm për qëllime lehtësimi dhe reference dhe këto nuk do të ndikojnë në asnjë mënyrë në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. SHITJA DHE BLERJA E PRODHIMIT NETO TË ENERGJISË ELEKTRIKE

2.1. Sigurimi i Prodhimit Neto të Energjisë Elektrike

2.1.1. Detyrimet e Shitjes dhe Blerjes Ekskluzive

Duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi (siç parashikohet në Nenin 8.1. këtu më poshtë), në përputhje me Kodin e Transmetimit dhe Rregullat e Tregut, dhe gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje, Shitësi do të:

deklarojë te OST (gjithashtu edhe te Blerësi), në kohën e duhur dhe përpara kohës së dispecerimit faktik, siç parashikohet në Kodin e Transmetimit, prodhimin neto të disponueshëm të energjisë elektrike, të shprehur në kW/h dhe kWh, për t'u lëvruar tek Blerësi në Pikën e Lëvrimit (“Prodhimi i Deklaruar”); dhe

të lëvrojë të gjithë Prodhimin Neto të Energjisë Elektrike te Blerësi.

Blerësi do të marrë ose do të paguajë për të gjithë këtë Prodhim të Deklaruar dhe është i detyruar të kryejë Pagesat e Blerësit siç është parashikuar më tej në Nenin 3.1. më poshtë (*Pagesat e Blerësit*), pavarësisht nga çdo lëvrim faktik sipas paragrafit (b) më sipër, me kusht, megjithatë, që Shitësi të jetë i gatshëm dhe në gjendje për të lëvruar këtë Prodhim të Deklaruar. (për këtë qëllim, çdo lëvrim nga OST në përputhje me nenin 2.5. do të konsiderohet se ka qenë “gati dhe në gjendje për t'u lëvruar” nga Shitësi).

Palët bien dakord që Shitësi, pa miratimin paraprak me shkrim të Blerësit, nuk do të shesë apo nuk do të lëvrojë energjinë elektrike të prodhuar nga Hidrocentrali te ndonjë person i ndryshëm nga Blerësi, përveç (i) në masën e nevojshme për shfrytëzimin e Hidrocentralit apo për shfrytëzimin e sigurt dhe pa rreziqe të sistemit të energjisë elektrike sipas udhëzimeve të OST (duke e njoftuar Blerësin menjëherë pas kësaj), (ii) siç parashikohet shprehimisht në Nenin 2.1.2. (*Përjashtimi i Përkohshëm i Detyrimeve të Shitjes dhe Blerjes*

Ekskluzive) dhe Nenin 8.4. (a) (Zgjidhja nga Shitësi pas Rastit të Mospërmbushjes së Marrëveshjes nga Blerësi).

Blerësi do t'i japë Shitësit një plan ku specifikohen furnizimet e tij të lëshimit të ujit për tre (3) muajt e ardhshëm. Palët do të takohen çdo javë me qëllim që të përcaktojnë dhe rregullojnë furnizimet e lëshimit të ujit të bëra më parë nga KESH, për qëllimin e shfrytëzimit të sigurt dhe pa rreziqe të Hidrocentralit.

2.1.2 Përjashtim i Përkohshëm nga Shitja dhe Blerja Ekskluzive

Shitësi do të ketë të drejtë të shesë Prodhimin Neto të Energjisë Elektrike te Palët e Treta në përputhje me rrethanat e parashikuara në Nenin 8.1.2.

2.1.3 Programi i Energjisë – Parashikimi

Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit një plan ku specifikohen parashikimet mujore dhe javore të prodhimit.

2.2 Dispozitat për Dispecerimin e Prodhimit të Deklaruar

OST, ashtu si parashikohet në Kodin e Transmetimit dhe në Rregullat e Tregut, do të lëshojë Udhëzimet e Dispecerimit për krijimin e Prodhimit Neto të Energjisë Elektrike që pritet për t'u lëvruar nga Hidrocentrali në Pikën e Lëvritimit në çdo kohë gjatë Fazës së Shfrytëzimit ("Prodhimi i dispeceruar"), me kusht që Prodhimi i Dispeceruar nuk do ta kalojë kurrë Prodhimin e Deklaruar. Këto Udhëzime të Dispecerimit do të jenë në përputhje me (i) Prodhimin e Deklaruar dhe me (ii) shmangiet e udhëzuara që mund të bëjë OST me qëllim për të balancuar sistemin e kohës reale me sigurinë e sistemit.

Shitësi do të ketë të drejtë për të kontrolluar Prodhimin e Deklaruar përpara dispecerimit faktik sipas kufijve kohorë dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Transmetimit apo në Rregullat e Tregut (dhe në mungesë të këtij Kodi, ose këtyre rregullave, deri në njëzet e katër (24) orë para dispecerimit nga OST) dhe për sa do të jetë e nevojshme, do të konsiderohet së është kontrolluar përputhshmëria e Udhëzimeve përkatëse të Dispecerimit me këtë Prodhim të Deklaruar të kontrolluar.

2.3 Respektimi i Kufijve Teknike

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të interpretohet sikur i kërkon Shitësit për të shfrytëzuar Hidrocentralin, në çdo kohë, duke përfshirë dhe rastin e ndonjë emergjence ose Ndërprerjeje të Detyruar, në ndonjë mënyrë që nuk përputhet me specifikimet teknike të Hidrocentralit dhe kërkesat sipas Kodit të Transmetimit.

2.4. Shërbimet e Nevojshme

Shitësi do të bëjë vetë furnizimet me ujë dhe energji elektrike, trajtimin e ujërave të zeza dhe do të marrë përsipër të gjitha kostot, shpenzimet dhe përgjegjësitë në lidhje me këtë.

2.5. Kompensimi për Shmangie nga Prodhimi i Deklaruar

Në rastet kur, në çdo interval kohor (orë) gjatë ditës së shfrytëzimit, Prodhimi faktik Neto i Energjisë Elektrike të hidrocentralit (siç matet nga Sistemi i Matjes) është

- (i) më i ulët se Prodhimi i Dispeceruar për këtë interval kohor Shitësi do të kompensojë financiarisht OST, ose
- (ii) nëse pas udhëzimit të OST, është më i lartë se Prodhimi i Deklaruar, Shitësi do të kompensohet financiarisht nga OST.

Shuma e kompensimit do të llogaritet si diferenca ndërmjet (i) Prodhimit të Deklaruar ose Prodhimit të Dispeceruar, sipas rastit, për atë interval kohor dhe (ii) Prodhimit Neto të Energjisë Elektrike, e shumëzuar në çdo rast me çmimin përkatës të miratuar nga Rregullatori për shërbimet e balancimit të OST.

Për të hequr çdo dyshim, nuk do të ketë kompensim të dyfishtë të Shitësit (me fjalë të tjera, nëse Shitësi kompensohet nga OST për Prodhimin Neto të Energjisë Elektrike i cili tejkalon Prodhimin e Dispeceruar, Blerësi nuk do të jetë i detyruar të paguajë Çmimin e Blerjes për këto shuma).

Për të hequr çdo dyshim, dispozitat e mësipërme do të jenë objekt i Kodit të Transmetimit dhe Rregullave të Tregut të cilat do të jenë të zbatueshme kohë pas kohe.

3. ÇMIMI PËR NJËSI, PAGESA DHE FATURIMI

3.1. Pagesat e Blerësit

Që nga Data e Hyrjes në Fuqi, Blerësi do të bëjë Pagesat e Blerësit në shumat dhe afatet kohore të përcaktuara në Shtojcën II (Prodhimi i Deklaruar) duke përfshirë pagesat – nëse ka – për ndonjë Detyrim Takse të Jashtëzakonshme.

Pagesat e Blerësit do të bazohen në çmimin për njësi Tt0 dhe do të indeksohen në bazë të formulës së mëposhtme:

$$PPT_{tm} = \sum T_{t0} \times ((0.15 + 0.50 \times CPI_m + 0.35 \times PPI_m) \times Cci,m) + ETB_{t-1}$$

Ku:

PPT_{tm} është Pagesa e Blerësit mbi një bazë një-mujore, në Euro për kWh;
 T_{10} është çmimi për njësi në Datën e Hyrjes në Fuqi
 CPI_m është Indeksi i Çmimit të Konsumatorit mbi një bazë tre-mujore (duke përdorur mesataren e tre treguesve mujore të botuar më së fundi) për Shqipërinë, siç publikohen nga INSTAT, në lidhje me $t=0$
 PPI_m është Indeksi i Çmimit të Prodhuesit mbi një bazë tre mujore të Euro Zonës, publikuar nga OECD; në lidhje me $t=0$

CCi_m është Prodhimi i Deklaruar në kohën i për periudhën m , e shprehur në kW/orë

Indeksi i Pagesave të Blerësit duhet të bëhet mbi një bazë tre-mujore pas Datës së Hyrjes në Fuqi.

T_{10} , është çmimi për njësi për sa i përket ofertës së Shitësit që është 5.9 Euro-Cents/kWh (pesë pikë nëntë Euro-Cents për kilowat në orë).

DTJ_{t-1} Detyrimi i Taksës së Jashtëzakonshme që duhet të paguhet nga Blerësi për vitin e mëparshëm mbi një bazë një mujore.

3.1.1. Detyrimi i Taksës së Jashtëzakonshme

Si pjesë e Pagesave të Blerësit, sipas Nenit 3.1. më sipër, Blerësi do të kompensojë financiarisht Shitësin për çdo Detyrim Takse të Jashtëzakonshme gjatë Afatit të kësaj Marrëveshjeje. Kjo Dispozitë së bashku me Nenet [8, 11, 12.1, 12.4, 12.5, 12.6 dhe 12.7] të kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje dhe do të vazhdojnë të jenë të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme deri në momentin kur të gjitha detyrimet e parashikuara në Nenin 3.1.1. të përmbushen.

Shuma e Detyrimit të Taksës së Jashtëzakonshme, nëse ka, do të llogaritet në vitin e dhënë për vitin paraardhës. Çdo shumë e përcaktuar në këtë mënyrë do të pjesëtohet me numrin e muajve të mbetur të vitit kalendarik aktual dhe do t'i shtohet faturave përkatëse mujore.

Në rastin kur ndonjë Kosto Përmbledhëse e Taksave vjetore e vlerësuar aktualisht nga autoritetet përkatëse të taksave do të ndryshonte nga shuma e faturuar tek Blerësi (duke përfshirë këtu çdo zbritje që rezulton nga auditet e taksave), shumat përkatëse do t'i faturohen apo atribuohen menjëherë Blerësit, sipas rastit.

Për qëllime ilustrimi, kësaj Marrëveshjeje i është bashkëngjitur një shembull llogaritjeje si Shtojca IV.

3.2. Grafiku i Faturimit dhe i Pagesës

Brenda dhjetë Ditëve të para të Punës të çdo muaji kalendarik pas çdo periudhe mujore kalendarike që nga Data e Hyrjes në Fuqi, Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit një faturë të detajuar për çdo periudhë të faturuar, në të cilën do të specifikohen Pagesat Përkatese të Blerësit në përputhje me Nenin 3.1. më sipër (*Pagesat e Blerësit*). Detyrimet në fjalinë që vjen menjëherë para kësaj do të zbatohen pa rënë ndesh me Detyrimin e Shitësit për të paguar Tarifën e Koncesionit sipas Nenit [4.1.] të Marrëveshjes së Koncesionit (në cilësinë e tij si Koncesionar).

Çdo faturë do të bëhet e detyrueshme për t'u paguar dhe do të paguhet në Euro brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike pasi është marrë nga Blerësi ose, nëse kjo datë detyruese nuk është një Ditë Pune, ajo do të paguhet në Ditën e Punës pasardhëse (secila nga këto data do të quhet "Data e Pagesës"). Pavarësisht nga sa më sipër, fatura do të jetë e detyrueshme për t'u paguar dhe do të paguhet në Lekë nëse Shitësi njofton Blerësin të paktën 5 Ditë Pune para Datës së Pagesës që kërkon pagesën në lekë, rast në të cilin pagesat do të bëhen në Lekë në vend të Euro mbi bazën e këmbimit fiks EURO/LEKË të shpallur nga Banka e Shqipërisë 5 Ditë Pune para Datës së Pagesës.

Të gjitha pagesat e Blerësit, sipas këtij neni, do të bëhen me transfertë bankare në llogarinë bankare të specifikuar nga Shitësi në bazë të një njoftimi të arsyeshëm para Datës së Pagesës.

Nëse vërtetohet se Blerësi ka paguar më tepër në lidhje me çdo faturë siç është thënë më lart, teprica e pagesës do t'i kthehet nga Shitësi menjëherë Blerësit në mënyrën e treguar nga Blerësi.

Në rastin kur ndonjë pagesë që duhet të bëhet në një kohë të caktuar, nuk është bërë brenda periudhës së kohës të specifikuar në këtë Nen, Blerësi do t'i paguajë Shitësit shumën e faturuar plus interesat e përditshëm për çdo ditë vonesë të pagesës. Interesi i përditshëm i thënë më sipër do të llogaritet në përputhje me Normën e Interesit të Pagesës së Vonuar.

3.3. Kreditimi i Shtuar – Garancia Bankare

Jo më vonë se Data e Hyrjes në Fuqi, Blerësi duhet të sigurojë nxjerrjen e një garancie bankare, rradhës së parë, e cila plotësohet kryesisht në formën e bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje si Shtojca III (*Forma e Garancisë Bankare të Blerësit*) e nxjerrë nga një Bankë me një reputacion të mirënjohur ndërkombëtar dhe që operon në Shqipëri (edhe nga një degë e saj), e cila rregullohet nga Ligji Shqiptar dhe që siguron detyrimin e Blerësit për të bërë Pagesat e Blerësit në përputhje me këtë Marrëveshje ("Garancia Bankare e Blerësit").

Blerësi do të sigurojë mbajtjen, ripërtëritjen dhe vlefshmërinë e Garancisë Bankare të Blerësit deri në përfundimin e afatit.

Garancia Bankare e Blerësit do të jetë në shumën 3 milion EUR (tre milion Euro), e ripërtërirë në Janarin e çdo viti me një shumë të zmadhuar duke përdorur mekanizma të njëjtë indeksimi me ata që janë përdorur për Pagesat e Blerësit dhe do të plotësohet menjëherë në rast të ndonjë pakësimi.

Shitësi do të ketë të drejtë të kërkojë çdo pagesë të papaguar të Blerësit sipas Garancisë Bankare të Blerësit, pas një njoftimi prej pesë (5) ditësh drejtuar Blerësit sipas të cilit pagesa vazhdon të jetë e papaguar edhe pas kalimit të Datës së Pagesës përkatëse (përveç kur pagesa përkatëse është bërë ndërkohë).

4. SHFRYTËZIMI DHE FUNKSIONALITETI I HIDROCENTRALIT

4.1. Mbajtja e të Dhënave të Shfrytëzimit

- (a) Shitësi do të mbajë të dhëna të sakta dhe të plota dhe çdo të dhënë tjetër të kërkuar për qëllime administrimi të saktë dhe në kohë të kësaj Marrëveshjeje, siç janë të dhënat në lidhje me Prodhimin Neto të Energjisë Elektrike, Prodhimin e Deklaruar, Ndërprerjet, etj.
- (b) Blerësi do të ketë të drejtë, pas një njoftimi paraprak prej dhjetë (10) ditësh drejtuar Shitësit, të marrë, me shpenzimet e veta, një kopje të të dhënave dhe të informacionit (në formë elektronike, siç është e përshtatshme) të Palës Tjetër në lidhje me këtë Marrëveshje apo shfrytëzimin dhe Dispecerimin e Hidrocentralit.

4.2. Funkcionaliteti i Hidrocentralit për Prodhimin e Dispeceruar

Shitësi do t'i deklarojë OST në kohë, në përputhje me Kodin e Transmetimit, kapacitetin e Hidrocentralit të cilin Shitësi do ta vendosë në shfrytëzim për prodhimin e energjisë elektrike dhe kapacitetin e gatshëm për t'u vënë në shfrytëzim (kapacitet rezervë).

4.3 Bilancet dhe Raportet

Shitësi do të marrë masa të pranueshme në mënyrë të arsyeshme nga Blerësi në lidhje me instalimin dhe funksionimin e një sistemi kontabiliteti dhe kontrolli të kostos, për caktimin e një firme si auditor ose të financierëve të caktuar në mënyrë të pavarur, të pranuar në mënyrë të arsyeshme nga Blerësi. Shitësi do të mbajë të dhëna të plota dhe të sakta në lidhje me të gjitha fazat e Projektit.

5. MATJA

5.1. Sistemi i Matjes

Sistemi i Matjes do të përfshijë sa më poshtë:

(i) një “Sistem Matës Kontrolli”; një aparat matës hidraulik dhe matës prodhimi si dhe pajisjet në lidhje me to, të furnizuara nga Shitësi dhe të transportuara përkatësisht tek Blerësi dhe OST, dhe që janë në pronësi dhe shfrytëzohen nga OST pas fillimit të Fazës së Shfrytëzimit;

dhe

(ii) një “Sistem Matës Kryesor”: një aparat matës hidraulik dhe matës prodhimi si dhe pajisjet në lidhje me to që janë në pronësi dhe shfrytëzohen nga Shitësi (së bashku “Sistemet e Matjes”)

Në përputhje me Shtojcën I të kësaj Marrëveshjeje (*Kërkesat Minimale të Sistemeve të Matjes*), Shitësi, me shpenzimet e veta, do të sigurojë dhe instalojë Sistemin Matës Kryesor dhe Sistemin Matës të Kontrollit, të cilët do të përfshijnë të gjithë matësit dhe pajisjet përkatëse për të matur kushtet hidraulike, Prodhimin Neto të Energjisë Elektrike dhe energjinë reaktive, siç parashikohet në Kodin e Transmetimit dhe në Kodin e Matjes, siç mund të jenë amenduar.

Menjëherë pas Hyrjes në Fuqi, Shitësi do të kalojë një matës prodhimi dhe pajisjet lidhur me të dhe një grup pajisjesh të matjes hidraulike dhe pajisjet lidhur me të, tek OST dhe Blerësi. OST, pas kësaj, do të mirëmbajë Sistemin Matës të Kontrollit me shpenzimet e veta dhe Shitësi do të mirëmbajë Sistemin Matës Kryesor me shpenzimet e veta. Sistemet matëse do të jenë në përputhje me specifikimet e pasqyruara në Kodin e Matjes dhe në Kodin e Transmetimit.

Të gjitha pajisjet e matjes të përdorura për të siguruar të dhëna për llogaritjen e pagesave të detyrueshme për t’u paguar, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të vulosen dhe këto vula nuk duhet të prishen përveç kur prishen bashkërisht nga përfaqësuesit e caktuar nga Palët, kur këto pajisje të matjes duhet të kontrollohen dhe testohen ose rregullohen siç parashikohet më poshtë.

Shitësi do të inspektojë, testojë dhe kalibrojë Sistemet e Matjes pas instalimit dhe të paktën një herë në pesë vjet pas kësaj. Blerësi do të rimbursojë Shitësin për kostot e tij të arsyeshme që kanë rrjedhur nga kontrolli, testimi dhe kalibrimi i Sistemit Matës të Kontrollit. Shitësi do t’i japë Blerësit një njoftim të arsyeshëm paraprak dhe do të lejojë një përfaqësues të Blerësit të jetë i pranishëm dhe të verifikojë këto kontrole, teste, dhe kalibrime. Pas kërkesës me shkrim të Blerësit dhe në praninë e një përfaqësuesi të Blerësit, Shitësi do të kryejë kontrole, testime ose kalibrime shtesë të Sistemit Matës brenda njëzet (20) ditësh pas datës së kësaj kërkesë me shkrim. Shpenzimet faktike të çdo kontrolli, testimi apo kalibrimi shtesë të kërkuar do të mbulohen nga Blerësi. Nëse ndonjë nga komponentët e Sistemit Matës Kryesor, do të gjendet me defekt ose i pasaktë, Shitësi, me shpenzimet e veta, do të

rregullojë, riparojë, zëvendësojë dhe/ose do të ri-kalibrojë këtë komponent duke e çuar aq afër sa është e mundur me një gjendje me nivel gabimi zero. Nëse ndonjë nga komponentët e Sistemit Matës të Kontrollit do të gjendet me defekt ose i pasaktë, Shitësi, me shpenzimet e Blerësit do të rregullojë, riparojë, zëvendësojë dhe/ose ri-kalibrojë këtë komponent duke e çuar aq afër sa është e mundur me një gjendje me nivel gabimi zero.

5.2. Rregullimi i Matësve të Pasaktë

Nëse ndonjë komponent i Sistemit Matës Kryesor nuk arrin të regjistrojë, ose nëse ndonjë nga matjet e bëra nga ky komponent gjendet, në bazë të testimit, e pasaktë, duhet të bëhet një rregullim duke korrigjuar të gjitha matjet e bëra nga komponenti me defekt apo i pasaktë për shumën e pasaktë dhe periudhën e pasaktësisë, në mënyrën e mëposhtme:

siç mund të bihet dakord nga Palët; ose

nëse Palët nuk bien dakord mbi shumën e rregullimit të nevojshëm për të korrigjuar matjet e bëra nga ndonjë komponent me defekt ose i pasaktë, Palët do të përdorin Sistemin Matës të Kontrollit për të përcaktuar shumën e kësaj pasaktësie dhe, nëse Sistemi Matës i Kontrollit gjendet gjithashtu i pasaktë, Palët do të vlerësojnë shumën e rregullimit të nevojshëm mbi bazën e shpërndarjeve së Prodhimit Neto të Energjisë Elektrike gjatë periudhave me kushte të njëjta shfrytëzimi kur Sistemet e Matjes regjistrojnë në mënyrë të saktë;

nëse Palët nuk bien dakord mbi periudhën faktike gjatë të cilës janë bërë matjet e pasakta, periudha gjatë të cilës matjet do të rregullohen do të jetë më e shkurtër se (i) gjysma e fundit e periudhës nga përfundimi i testimit të mëparshëm të Sistemeve të Matjes, ose ii) 60 ditë menjëherë para testimit i cili konstatoi se një ose të dy Sistemet e Matjes kishin defekte ose ishin të pasaktë.

në masën që çdo periudhë rregullimi e tillë mbulon një periudhë lëvrimesh për të cilën është bërë tashmë pagesa nga Blerësi, Shitësi do të përdorë vlerat e korrigjuara të matjes siç përcaktohet në përputhje me Nenet 5.2(a), (b) ose (c) të kësaj Marrëveshjeje për të rillogaritur shumën e detyrueshme për t'u paguar për periudhën e pasaktësisë dhe do të zbresë pagesat e mëparshme të bëra nga Blerësi për këtë periudhë nga çdo shumë e tillë e rillogaritur. Nëse diferenca është një numër pozitiv, diferenca do të paguhet nga Blerësi tek Shitësi. Nëse diferenca është numër negativ, diferenca do të zbritet si një kompensim nga pagesat e detyrueshme për t'iu paguar Shitësit nga Blerësi.

5.3. Kodi i Matjes

Pavarësisht nga çdo gjë e parashikuar në këtë Nen 5, në rast mospërputhjeje ose mbivendosjeje ndërmjet Kodit të Matjes dhe Neneve 5.1. dhe 5.2 më sipër, Kodi i Matjes do të ketë përparësi.

6. NDËRPRERJET E ENERGJISË ELEKTRIKE TË PLANIFIKUARA DHE TË DETYRUARA

Nenet e mëposhtëm do t'i nënshtrohen Kodit të Transmetimit me ndryshimet e tij të herëpashershme.

6.1. Ndërprerjet e Planifikuara për Mirëmbajtjen Kryesore

Shitësi do t'i paraqitë OST grafikun e tij vjetor të propozuar të ndërprerjeve sipas afateve kohore dhe kërkesave të të dhënave të përcaktuara në Kodin e Transmetimit.

OST, në përputhje me dispozitat e Kodit të Transmetimit, do të harmonizojë ndërprerjen e gjenerimit, transmetimit dhe objekteve përdoruese të mëdha, me qëllim për të maksimizuar sigurinë e sistemit duke minimizuar ndërkohë shmangiet nga grafiku i propozuar i ndërprerjeve të dhënë nga përdoruesit e sistemit të transmetimit.

OST, para mbarimit të çdo viti kalendarik dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet kohore të parashikuara në Kodin e Transmetimit, do të nxjerrë një plan ndërprerjesh të sistemit të koordinuar të gjenerimit, transmetimit dhe objekteve përdoruese të mëdha për vitin pasues kalendarik.

6.2. Ndërprerjet e Detyruara

Nëse Shitësi ndërmerr një ndërprerje të pjesshme apo të plotë të Hidrocentralit pa dhënë më parë një njoftim paraprak prej 6 orësh ose nëse ndonjë ndërprerje tejkalon maksimumin e lejueshëm, ndërprerja do të konsiderohet se përbën një Ndërprerje të Detyruar.

6.3. Njoftimi i Ndryshimeve në Gjendjen e Shfrytëzimit

Shitësi do të njoftojë OST sa më shpejt të jetë e mundur për çdo ndryshim të rikthimit të pritshëm të Shitësit në gjendjen e shfrytëzimit pas një ndërprerje.

7. FORCA MADHORE DHE SHKARKIM I TË DYJA PALËVE NGA PËRGJEGJËSIA

7.1. Forca Madhore

“Rast i Forcës Madhore” do të thotë çdo rrethanë që nuk është brenda kontrollit të arsyeshëm, të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë të palës së cenuar (“Pala e Cenuar”) duke sjellë si pasojë ose duke shkaktuar mospërmbushje të plotë ose të pjesshme të të gjitha Detyrimeve të Palës së

Cenuar sipas kësaj Marrëveshjeje (përveç pagesës së parave), por vetëm nëse dhe në masën që:

kjo rrethanë, pavarësisht nga ushtrimi i një kujdesi të arsyeshëm nuk mund ose nuk mund të ishte parandaluar, shmangur ose larguar nga Pala e Cenuar;

Pala e Cenuar mori ose ka marrë të gjitha masat paraprake të arsyeshme, ka treguar kujdesin e duhur dhe ka marrë masa të arsyeshme alternative me qëllim që të shmangë pasojën e këtij rasti, në aftësinë e Palës së Cenuar për të përmbushur detyrimet e veta sipas Kësaj Marrëveshjeje dhe të lehtësojë pasojat e kësaj;

Rasti nuk është, ose nuk ishte rezultat i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i shkeljes nga Pala e Cenuar të çdo detyrimi të saj sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

Pala e Cenuar i ka dhënë njoftim Palës tjetër (Palës së Pacenuar”) Rastet e Forcës Madhore përfshijnë rrethanat e mëposhtme me kusht që të plotësohet kriteri i specifikuar qartësisht në përkufizimin e Rastit të Forcës Madhore më lart:

aktet e luftës, pushtimi nga një armik i huaj, ose aktet e terrorizmit, bllokadat, embargot, racionimin;

aktet e rebelimit, përmbytjet, trazirat civile, grevat me natyrë politike, aktet ose fushatat e terrorizmit;

rrufetë, zjarret, tërmetet, stuhitë, ciklonet, tajfunet, uraganet ose fatkeqësitë e tjera natyrore;

epidemitë ose murtajat; dhe

çdo akt sabotazhi, grevë, kryerje e punës në nivel minimal në krahasim me atë që kërkohet nga rregullat e punës ose kryerje e ngadaltë e punës (në çdo rast përveç kur punëmarrësit e palës ose çdo aksioner i kësaj pale, ose punonjësit e ndonjë Filiali të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, shoqërie mëmë ose Dege të çdo aksioneri të kësaj pale e pretendojnë këtë si një rast të Forcës Madhore).

Pala e Cenuar do të shkarkohet nga përmbushja e kësaj Marrëveshjeje dhe kjo nuk do të konsiderohet si mospërmbushje për aq kohë sa dhe në masën që kjo mospërmbushje shkaktohet nga një Rast i Forcës Madhore, dhe Afati i Marrëveshjes do të zgjatet automatikisht nga kohëzgjatja e Rastit të Forcës Madhore.

7.2. Shkarkimi nga Përgjegjësia në lidhje me Marrëveshjen e Koncesionit – Moskompensim i Dyfishtë

7.2.1. Shkarkimi nga Përgjegjësia në lidhje me Marrëveshjen e Koncesionit

Në rastin kur Shitësi nuk është i aftë të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, si pasojë e drejtpërdrejtë e Rastit të Mospërmbushjes nga ana e Autoritetit Kontraktues, e një Rasti të Forcës Madhore ose VSHKM sipas Marrëveshjes së Koncesionit, Shitësi do të shkarkohet nga përmbushja sipas kësaj Marrëveshjeje, me kusht, megjithatë, që, Shitësi do të ushtrojë vetëm ato mjete ligjore mbrojtëse që i lejohen sipas Marrëveshjes së Koncesionit dhe nuk do të ketë asnjëherë të drejtë të kompensohet nga Blerësi në lidhje me këto ngjarje apo rrethana.

7.2.2. Moskompensim i Dyfishtë

Nëse, për çfarëdo arsye, Shitësi ka të drejtë të jetë subjekt i çdo të drejte, mjeti ligjor mbrojtës ose kompensimi në lidhje me të njëjtat ngjarje apo rrethana si nga (i) Autoriteti Kontraktues sipas Marrëveshjes së Koncesionit ashtu dhe nga (ii) Blerësi sipas kësaj Marrëveshjeje, Shitësi do ta ushtrojë këtë të drejtë ose ndaj Autoritetit Kontraktues ose ndaj Blerësit por në asnjë rast nuk do të ketë të drejtë për kompensim të dyfishtë.

Nëse, pavarësisht nga sa më sipër, Shitësi përfiton nga të drejta, mjete ligjore mbrojtëse apo kompensime të tilla të dyfishta, nga Blerësi, në lidhje me këto ngjarje apo rrethana, ai do t'i rimbursojë menjëherë, nuk do t'i ushtrojë ato dhe ndryshe do t'i transferojë ato tek Blerësi.

8. AFATI DHE ZGJIDHJA

8.1. Hyrja në Fuqi dhe Afati i kësaj Marrëveshjeje

8.1.1 Hyrja në Fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi dhe do të ketë efekt pas datës së Përfundimit Thelbësor (sipas Marrëveshjes së Koncesionit) dhe pas miratimit të Rregullatorit, cilido kryhet më vonë ("Hyrja në Fuqi").

8.1.2. Afati – Pezullimi – Ripërtëritja e Marrëveshjes

- (a) Përveç rastit të zgjidhjes para afatit apo zgjatjes së afatit në përputhje me kushtet e saj, kjo Marrëveshje do të jetë në fuqi dhe do të ketë efekt për një periudhë prej pesëmbëdhjetë (15) vjetësh nga Hyrja në Fuqi ("Afati").
- (b) Shitësi nuk do të ketë të drejtë të kërkojë ri-negociime të kushteve të kësaj Marrëveshjeje gjatë pesë (5) viteve të para.

- (c) Në rastin kur regjimi i funksionimit të Kaskadës së lumit Drin të Blerësit ndryshon nga prodhimi mbizotërues i “ngarkesës elektrike bazë” në prodhimin e “ngarkesës elektrike kulminante” dhe në rastin kur ky ndryshim ka një Pasojë Thelbësisht të Dëmshme mbi Shitësin, Shitësi do të ketë të drejtë të japë një njoftim (duke parashikuar arsyet për këtë) duke kërkuar një rritje në çmimin e shitjes me qëllim që të kompensojë ndikimin negativ të ndryshimit në regjimin e funksionimit të Kaskadës së Lumit Drin (duke përfshirë, por pa u kufizuar në, çdo investim shtesë të kërkuar për ri-projektimin e Hidrocentralit dhe/ose Objekteve Ekzistuese). Ndryshimi në çmimin e shitjes do të jetë i zbatueshëm për periudhën e kohës që fillon nga Pretendimi i Shitësit.

Në rastin kur Blerësi ose (i) nuk jep pëlqimin e vet për këtë rritje, ose (ii) nuk e paguan ose pushon së paguari shumë e zmadhuar pas një njoftimi 30-ditor nga Shitësi, kjo do të përbëjë një Rast të Mospërmbushjes së Marrëveshjes nga Blerësi dhe do të zbatohet Neni 11.2.2 (a) i Marrëveshjes së Koncesionit.

- (d) Në rastin kur Marrëveshja për Shitjen e Energjisë Elektrike dhe Marrëveshja e Koncesionit zgjidhen si pasojë e sa më sipër dhe në përputhje me Nenin 11.2.2 (a) të Marrëveshjes së Koncesionit, (i) Autoriteti Kontraktues do të detyrohet t'i bëjë Koncesionarit Pagesat A dhe B të zgjidhjes në përputhje me Nenin 11.3. të Marrëveshjes së Koncesionit, dhe për më tepër, (ii) Blerësi do të detyrohet t'i bëjë Shitësit Pagesën C të zgjidhjes (siç parashikohet në Nenin 11.3. të Marrëveshjes së Koncesionit) brenda tridhjetë (30) ditësh nga zgjidhja e Marrëveshjes së Koncesionit. Të paktën gjashtë (6) muaj para mbarimit të afatit, Palët do të angazhohen me mirëbesim në bisedime me qëllim ripërtëritjen e Marrëveshjes për një periudhë tjetër për të cilën do të bihet dakord, e cila, megjithatë, do të jetë e kufizuar nga afati i Marrëveshjes së Koncesionit, dhe Palët do të sigurojnë që afatet dhe kushtet e përgjithshme të marrëveshjes së ripërtëritje do të reflektojnë kryesisht kushtet e kësaj Marrëveshjeje, me kusht, megjithatë, që marrëveshja e ripërtëritje do të reflektojë edhe kushtet mbizotëruese të tregut në momentin e ripërtëritjes.

Në lidhje me sa më sipër, Palët do t'i kushtojnë vëmendjen e duhur sistemit rregullator dhe ligjor dhe mjedisit ekonomik ekzistues në Shqipëri dhe në Bashkimin Evropian në momentin e ripërtëritjes, (duke përfshirë edhe kushtet e ligjit të konkurrencës), për të siguruar përputhjen e marrëveshjes së ripërtëritje me to.

Nëse Palët nuk arrijnë të bien dakord mbi ripërtëritjen e përmendur më lart, para ose në përfundim të Afatit, ose nëse sipas opinionit të arsyeshëm të Palëve, mjedisi ekonomik, rregullator dhe ligjor në Shqipëri dhe në Bashkimin Evropian, në momentin e ripërtëritjes, nuk është i përshtatshëm, për këtë

ripërtëritje (i) kjo Marrëveshje do të zgjidhet me mbarimin e afatit dhe nuk do të ripërtërihet (dhe për të hequr çdo dyshim, zgjidhja e sipërpërmendur nuk do të përbëjë një shkelje të marrëveshjes nga ana e secilës Palë); (ii) Marrëveshja e Konçesionit nuk do të zgjidhet (por Tarifa e Konçesionit mund të përshtatet në përputhje me Nenin 4.1 të Marrëveshjes së Konçesionit); dhe (iii) Shitësi do të ketë të drejtë të shesë të gjithë Prodhimin Neto të Energjisë Elektrike në treg të hapur në përputhje me Kodin e Transmetimit dhe Rregullat e Tregut.

Procesi i ripërtëritjes do të kryhet në të njëjtën mënyrë para mbarimit të afatit të çdo Marrëveshjeje të ripërtëritur, derisa (i) Palët nuk kryejnë një ripërtëritje për arsyt e përmendura më lart, ose (ii) deri në mbarimin e afatit të Marrëveshjes së Konçesionit, cildo që ndodh më parë.

8.2 Rastet e Mospërbushjes nga Shitësi

Secili nga rastet më poshtë do të përbëjë një Rast të mospërbushjes nga Shitësi (“Rast i Mospërbushjes nga Shitësi”), të cilët nëse nuk përmbushen brenda periudhës kohore të lejuar (nëse ka), do të çojnë në lindjen e të drejtës së Blerësit për të dhënë një Njoftim Zgjidhjeje; me kusht, megjithatë, që asnjë rast i tillë nuk do të bëhet një Rast i Mospërbushjes nga Shitësi nëse rezulton kryesisht nga (i) një shkelje e kësaj Marrëveshjeje nga Blerësi, (ii) një Rast i Forcës Madhore, ose (iii) një Rast i Mospërbushjes nga Autoriteti Kontraktues sipas Marrëveshjes së Konçesionit:

- (a) Zhvillimi i ndonjë prej ngjarjeve të mëposhtme: (i) marrja e një vendimi nga aksionerët e Shitësit për likuidimin e Shitësit përveç rastit të një ristrukturimi me qëllim rritjen e aftësisë pagueuse; (ii) një kërkesë vullnetare e Shitësit për shpalljen e gjendjes së falimentit, moratoriumi ose një rregullim tjetër i ngjashëm; (iii) emërimi i një likuidatori në procedurën e likuidimit të Shitësit pasi të jetë bërë njoftimi dhe seanca gjyqësore në mënyrën e duhur, emërim i cili nuk është lënë mënjane ose nuk është pezulluar brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga data e këtij emërimi; ose (iv) dhënia e një vendimi likuidimi të Shitësit nga një gjykatë që ka juridiksion mbi Shitësin, dhe që nuk është pezulluar ose rrëzuar nga një gjykatë kompetente brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve; ose
- (b) (i) Moskryerja nga ana e Shitësit, në mënyrë të vazhdueshme, e shfrytëzimit, mirëmbajtjes, modifikimit ose riparimit të Hidrocentralit në përputhje me Praktikat e Industrisë së Mirë, në mënyrë të tillë që siguria e personave dhe e pronës, e Hidrocentralit, ose e shërbimeve të Blerësit ndaj Klientëve cenohet në mënyrë të rëndë, ose (ii) çdo shkelje thelbësore nga Shitësi e çdo angazhimi dhe zotimi detyrues thelbësor të arritur në këtë Marrëveshje, të cilat në çdo rast, nuk janë ndrequr brenda tridhjetë (30) ditëve pas njoftimit të Blerësit, ku identifikohet shkelja në fjalë duke dhënë detaje të arsyeshme, dhe ku kërkohet ndreqje për këtë shkelje; me kusht, megjithatë, që për çdo mospërbushje të tillë që mund të

rregullohet vetëm në më shumë se tridhjetë (30) ditë, Shitësit mund t'i jepet aq kohë shtesë për ta ndrequr atë shkelje sa ta vlerësojë ai se mund të jetë e nevojshme nëse, para mbarimit të periudhës prej tridhjetë (30) ditësh, Shitësi i jep prova të pranueshme Blerësit që (i) është filluar dhe është duke u ndjekur me kujdesin e duhur një ndreqje dhe që (ii) do të duhet më shumë se tridhjetë (30) ditë me qëllim që të kryhet një ndreqje e tillë dhe jep, në mirëbesim, një vlerësim se kur do të ndreqet kjo shkelje..

8.3. Rastet e Mospërmbushjes nga Blerësi

Secili prej rasteve të mëposhtëm do të jetë një rast mospërmbushjeje nga Blerësi (“Rast i Mospërmbushjes nga Blerësi”), i cili nëse nuk ndreqet brenda periudhës kohore të lejuar (nëse ka), do të pasillte zbatimin e Nenit 8.4 më poshtë; me kusht që sidoqoftë, asnjë rast i tillë nuk do të përbëjë një Rast të Mospërmbushjes nga Blerësi nëse rrjedh kryesisht nga (i) një shkelje thelbësore e kësaj Marrëveshjeje nga Shitësi, ose (ii) nga zhvillimi i një Rasti të Forcës Madhore:

çdo mospërmbushje ose mospërmbushjet nga Blerësi në kryerjen e të gjitha pagesave që duhet të bëhen në bazë të kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë Pagesat e Blerësit) brenda tridhjetë (30) ditëve nga data në të cilën duhej bërë pagesa (pa cenuar të drejtën e Shitësit për të ekzekutuar Garancinë Bankare të Blerësit në përputhje me Nenin 3.3);

çdo shkelje thelbësore të kësaj Marrëveshjeje nga Blerësi (të ndryshme nga ato të parashikuara në nën-pikën (a) më sipër), që nuk është ndrequr brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i Shitësit që identifikon shkeljen thelbësore në fjalë; ose

dhënia e një Njoftimi për Zgjidhje nga Shitësi, në përputhje me nenin 8.1.2 (c).

Në rastin kur Shitësi i jep një Njoftim për Zgjidhje Blerësit në lidhje me Rastin e Mospërmbushjes nga Blerësi në përputhje me këtë Marrëveshje, Shitësi ka të drejtë të kërkojë shumën e plotë të Garancisë bankare të Blerësit, pa cënuar çdo të drejtë ose mjet ligjor mbrojtës tjetër të Shitësit kundër Blerësit në përputhje me Ligjin.

Pasojat e Zgjidhjes –Zgjidhje e Tërthortë me Miratim

Zgjidhja nga Shitësi pas një Rasti Mospërmbushjeje nga Blerësi

Kur ndodh një Rast Mospërmbushjeje nga Blerësi:

- (i) Shitësi do të njoftojë për këtë rast si Blerësin, ashtu edhe Autoritetin Kontraktues;
- (ii) Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtën, por jo detyrimin, të përmbushë ose të sigurojë përmbushjen e Rastit të Mospërmbushjes nga Blerësi (pa cenuar çdo detyrim të Blerësit për të bërë të njëjtën gjë);
- (iii) Shitësi do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të identifikuar dhe për t'u angazhuar në bisedime me palë të treta blerëse të mundshme në treg në përputhje me Ligjin (si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë), me qëllimin që (a) të zëvendësojë Blerësin me këtë palë të tretë në rast të zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje dhe (b) të mundësojë vazhdimin e Marrëveshjes së Konçesionit;
- (iv) Nëse Autoriteti Kontraktues zgjedh të përmbushë Rastin e Mospërmbushjes nga Blerësi, Shitësi nuk do të ketë të drejtë t'i dërgojë një Njoftim Zgjidhjeje Blerësit, në çdo moment gjatë kësaj përmbushjeje;
- (v) nëse, pas kalimit të një periudhe prej nëntëdhjetë (90) ditësh pas njoftimit të Rastit të Mospërmbushjes nga Blerësi, drejtuar Blerësit dhe Autoritetit Kontraktues (siç është thënë më lart), (a) as Blerësi dhe as Autoriteti Kontraktues nuk e kanë përmbushur Rastin e Mospërmbushjes nga Blerësi, ose (b) nëse Blerësi vendos të mos e pranojë rishikimin e çmimit të rekomanduar nga Eksperti Teknik dhe Ekonomik, dhe (c) Shitësi, megjithë përpjekjet e arsyeshme, nuk arrin një Marrëveshje me palën e tretë për të zëvendësuar Blerësin, me kushte të pranueshme në mënyrë të arsyeshme (kjo marrëveshje nuk është e nevojshme të ketë të njëjtin afat me atë të kësaj Marrëveshjeje), Shitësi do të ketë të drejtë t'i japë Blerësit një Njoftim Zgjidhjeje. Gjithashtu, Shitësi do të ketë të drejtë të zgjidhë Marrëveshjen e Konçesionit; dhe
- (vi) Megjithatë, nëse, me kalimin e periudhës së sipërpërmendur prej nëntëdhjetë (90) ditësh, Shitësi ka arritur një marrëveshje me një palë të tretë për të zëvendësuar Blerësin me kushte të pranueshme në mënyrë të arsyeshme siç është përmendur më lart, Shitësi do të ketë të drejtë t'i japë një Njoftim Zgjidhjeje Blerësit por Marrëveshja e Konçesionit nuk do të zgjidhet pas kësaj, dhe Shitësi dhe Autoriteti Kontraktues do të amendojnë, ndryshojnë ose do të ristrukturojnë ndryshe Marrëveshjen e Konçesionit në mënyrë që të reflektojë këto rrethana duke marrë në konsideratë me mirëbesim interesat e tyre reciproke

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë të marrë çdo informacion të arsyeshëm nga Shitësi në lidhje me çdo marrëveshje të negociuar ndërmjet Shitësit dhe një pale të tretë të mundshme blerëse, dhe Autoriteti Kontraktues do ta trajtojë këto informacion si informacion konfidencial.

Zgjidhja nga secila Palë në Rastin e Forcës Madhore të Tejzgjatur

Nëse një Rast i Forcës Madhore sipas kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet një Rast i Forcës Madhore i Tejzgjatur sipas kësaj Marrëveshjeje, (i) secila Palë do të ketë të drejtë t'i japë Njoftim për Zgjidhje Palës tjetër dhe (ii) asnjë Palë nuk do të jetë përgjegjëse përkundrejt Palës tjetër në lidhje me zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje (me përjashtim të pagesave të detyrueshme, që duhet të paguhen dhe që janë ende të papaguara sipas kësaj Marrëveshjeje).

Zgjidhja nga secila Palë pas zgjidhjes së Marrëveshjes së Koncesionit

Kjo Marrëveshje do të zgjidhet automatikisht me zgjidhjen e Marrëveshjes së Koncesionit, dhe do të zbatohen sa më poshtë:

Zgjidhja e Marrëveshjes së Koncesionit për arsye të tjera

Në rastin kur kjo Marrëveshje zgjidhet vetëm si pasojë e zgjidhjes së Marrëveshjes së Koncesionit në përputhje me kushtet e parashikuara prej kësaj për çdo arsye të ndryshme nga ajo e Rastit të Mospërmbushjes nga Koncesionari, asnjë Palë nuk do të jetë përgjegjëse ndaj Palës tjetër në lidhje me zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje (me përjashtim të pagesave të detyrueshme, që duhet të paguhen dhe që janë ende të papaguara sipas kësaj Marrëveshjeje).

Mos-cenimi

Asgjë në nënparagrafin (i) më sipër nuk do të cenojë të gjitha të drejtat ose mjetet ligjore mbrojtëse të Autoritetit Kontraktues dhe/ose të Shitësit sipas Marrëveshjes së Koncesionit në lidhje me zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje

SIGURITË DHE GARANCITË

Siguritë dhe Garancitë e Shitësit

Shitësi me anë të kësaj Marrëveshjeje siguron dhe garanton Blerësin se:

Shitësi, pas transferimit të kësaj Marrëveshjeje te Shoqëria e Projektit në përputhje me pikën (A) të Deklarimit Hyrës, do të jetë një shoqëri aksionere, ose një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar në mënyrë të rregullt,

që ekziston në mënyrë të vlefshme dhe me status aktiv sipas Ligjit dhe ka të gjitha kompetencat e kërkuara dhe autoritetin për të kryer aktivitetin e saj ashtu si drejtohet aktualisht dhe si është propozuar të drejtohet;

Shitësi ka të drejta të plota dhe autoritet për të nënshkruar, për të përmbushur detyrimet e tij sipas saj dhe e nënshkruan në mënyrë të rregullt këtë marrëveshje;

Kjo Marrëveshje përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe që e angazhon në mënyrë të detyrueshme Shitësin;

Për aq sa ka dijeni dhe pasi janë kryer kërkime të arsyeshme, Shitësi deklaron se nuk kërkohet asnjë leje, autorizim ose miratim specifik për nënshkrimin, transferimin ose përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje nga Shitësi, megjithatë, nëse në një fazë të mëvonshme rezulton që kërkohet ndonjë leje, autorizim ose miratim i tillë, Shitësi garanton se do të pajiset me këtë leje, autorizim ose miratim;

Shitësi nuk është në situatë mospërmbushjeje sipas ndonjë marrëveshjeje apo dokumenti tjetër ligjor të çfarëdolloj natyre qoftë në të cilën është palë ose nga e cila detyrohet në mënyrë të tillë që mund të ketë një pasojë thelbësisht në kundërshtim me aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje si dhe me vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e saj; dhe

Nuk ka asnjë veprim, padi, procedim, apo hetim të pazgjidhur kundër Shitësit i cili do të kishte një pasojë thelbësisht në kundërshtim me aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe me vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e saj.

Siguritë dhe Garancitë e Blerësit

Blerësi me anë të kësaj Marrëveshjeje, siguron dhe garanton Shitësin që:

Është një shoqëri aksionere e njohur me ligj e krijuar sipas Ligjeve të Shqipërisë dhe ka të gjitha kompetencat e kërkuara dhe autoritetin për të ushtruar aktivitetin e saj ashtu si drejtohet aktualisht dhe si është propozuar të drejtohet;

ka kompetenca dhe autoritet të plotë për të nënshkruar, për të përmbushur detyrimet e veta në të dhe që e nënshkruan në mënyrë të rregullt këtë Marrëveshje;

Kjo Marrëveshje përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe që e angazhon në mënyrë të detyrueshme Blerësin;

Për aq sa ka dijeni dhe pasi janë kryer kërkime të arsyeshme, Blerësi deklaron se nuk kërkohet asnjë leje, autorizim ose miratim specifik për nënshkrimin, transferimin ose përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje nga Blerësi;

Blerësi nuk është në situatë mospërmbushjeje sipas ndonjë marrëveshjeje apo dokumenti tjetër ligjor i çfarëdolloj natyre qoftë në të cilën është palë ose nga e cila detyrohet në mënyrë të tillë që mund të ketë një pasojë thelbësisht në kundërshtim me aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje si dhe me vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e saj;

Nuk ka asnjë veprim, padi, procedim, apo hetim të pazgjidhur kundër Blerësit i cili do të kishte një pasojë thelbësisht në kundërshtim me aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe me vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e saj.

TAKSAT

10.1 Taksat e Zbatueshme ndaj Shitësit

Në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Koncesionit si dhe me Nenin 3.1.1 të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha taksat, tatimet, tarifat, apo detyrime të tjera të ligjshme aktuale ose të ardhshme, të administratës qendrore ose lokale apo bashkiake, të zbatueshme ndaj Shitësit, Hidrocentralit, Projektit dhe asetëve të tjera të Shitësit, do të paguhen nga Shitësi në kohën e duhur.

10.2 Taksat e Zbatueshme ndaj Blerësit

Të gjitha taksat, tatimet, tarifat, apo detyrime të tjera të ligjshme, aktuale ose të ardhshme, të administratës qendrore ose lokale apo bashkiake, të zbatueshme ndaj Blerësit që lindin nga apo në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, do të paguhen nga Blerësi në kohën e duhur.

11 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Zgjidhje me Pajtim

Nëse do të lindë ndonjë mosmarrëveshje nga kjo Marrëveshje ose në lidhje me të ("Mosmarrëveshje"), secila nga Palët do t'i japë njoftim për këtë Palës tjetër pas të cilit Blerësi dhe Shitësi do të takohen menjëherë dhe do të përpiqen me mirëbesim të arrijnë një zgjidhje me pajtim.

11.2. Eksperti Teknik dhe Ekonomik

11.2.1 Mosarritja e zgjidhjes me pajtim

Nëse nuk arrihet një zgjidhjeje me pajtim në përputhje me Nenin 11.1 më sipër brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e njoftimit të parashikuar këtu, çdo Mosmarrëveshje do t'i paraqitet një ekspert (‘‘Eksperti Teknik dhe Ekonomik’’).

Përzgjedhja e Ekspertit Teknik dhe Ekonomik

Në mënyrë që të caktohet Eksperti Teknik dhe Ekonomik, (i) Blerësi dhe Shitësi do të caktojnë secili një (1) ekspert brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas mbarimit të periudhës së sipërpërmendur për zgjidhjen me pajtim, dhe (ii) ekspertët respektivë së bashku do të caktojnë Ekspertin Teknik dhe Ekonomik sa më shpejt që të jetë e mundur.

Fuqia ligjore e vendimeve të Ekspertit Teknik dhe Ekonomik

Përveç sa parashikohet shprehimisht këtu, vendimet e Ekspertit Teknik dhe Ekonomik do të kenë vetëm vlerën e rekomandimeve për Blerësin dhe Shitësin dhe nuk do të përbëjnë vendime detyruese për ta, (duke përfshirë qëllimet e procedurave të arbitrazhit siç parashikohet në Nenin 11.3 më poshtë).

Arbitrazhi

Nëse një Mosmarrëveshje nuk është zgjidhur ndërmjet Palëve nëpërmjet zgjidhjes me pajtim ose në sajë të Ekspertit Teknik dhe Ekonomik, Mosmarrëveshja mund t'i paraqitet arbitrazhit ndërkombëtar.

Marrëveshja dhe të drejtat dhe detyrimet e Palëve sipas saj do të mbeten në fuqi dhe do të kenë efekt deri në daljen e një vendimi nga një proces i tillë arbitrazhi, vendim i cili, kur është e mundur, do të përcaktojë mënyrën dhe kohën së kur do të hyjë në fuqi një zgjidhje e caktuar.

Të gjitha procedurat e arbitrazhit lidhur me sa më sipër do të mbahen dhe zgjidhen përfundimisht në Paris, Francë dhe do të zhvillohen në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në prani të një paneli prej tre (3) arbitrash të caktuar në përputhje me këto Rregulla.

Arbitrazhi do të zhvillohet në gjuhën angleze dhe të gjitha dokumentet e paraqitura në lidhje me këtë procedurë do të jenë në gjuhën angleze ose të shoqëruara me një kopje të përkthyer në gjuhën angleze dhe të çertifikuar.

12. DISPOZITA TE NDRYSHME

Transferimi – Siguria

Palët nuk do të shesin, ngarkojnë, delegojnë ose transferojnë të drejtat ose detyrimet e tyre sipas ose në përputhje me këtë Marrëveshje pa miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër (miratim të cilin Blerësi në përputhje me pikën A të Deklarimit Hyrës këtu, e ka dhënë për sa i përket transferimit të Marrëveshjes të Shoqëria e Projektit); me kusht, megjithatë, që Shitësi do të ketë të drejtë në masën e lejuar nga ligji, dhe siç mund të kërkohej në bazë të Dokumenteve të Financimit, të delegojë, transferojë dhe/ose vendosë ndonjë barrë mbi të drejtat dhe interesat e tij sipas ose në përputhje me këtë Marrëveshje, ose mbi dhe për Projektin (por jo mbi Sheshin apo Objektet Ekzistuese, përveç rastit të të drejtave mbi dhe për ndonjë marrëveshje uzufrukti), në dobi të Palëve Financuese; dhe me kusht, megjithatë, që Blerësi do të japë pëlqimin e tij siç thuhet më lart në çdo kohë kur Autoriteti Kontraktues do të japë pëlqimin e tij për të njëjtat qëllime sipas Marrëveshjes së Koncesionit.

Çdo shitje, vënie barre, delegim ose transferim, faktike, e tentuar ose e synuar nga një Palë, e ndonjë prej të drejtave, detyrimeve ose interesat të saj, sipas ose në përputhje me këtë Marrëveshje që nuk pajtohet me kushtet të parashikuara këtu në Nenin 12.1 do të jetë nul, e pavlefshme dhe pa fuqi ose pasojë.

Në rast se KESH bën ndonjë ri-strukturim duke përfshirë por duke mos u kufizuar në, ndarjet, krijimin e filialeve ose çdo veprim të ngjashëm i cili rezulton në transferimin e kësaj Marrëveshjeje për shkak të veprimit të ligjit, KESH do të mbetet përgjegjës, individualisht dhe bashkërisht me atë të cilit i është transferuar Marrëveshja.

12.2. Ligjet e Zbatueshme

Shitësi dhe Blerësi do të veprojnë në përputhje me të gjitha Ligjet deri në mbarim të Afatit.

12.3. Përgjegjësia – Zhdëmtimi

Konçesionari dhe Shoqëria e Projektit do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe individualisht për të gjitha të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje.

Shitësi do të zhdëmtojë dhe nuk do të bëjë përgjegjës Blerësin në lidhje me çdo dëmtim, kosto, shpenzim ose përgjegjësi që rrjedh ose që rezulton nga neglizhenca e tij ose nga mosrespektimi i detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje. Anasjelltas, Blerësi do të zhdëmtojë dhe nuk do të bëjë përgjegjës Shitësin në lidhje me çdo dëmtim, kosto, shpenzim ose përgjegjësi që rrjedh ose që rezulton nga neglizhenca e tij ose nga mospërmbushja e detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

Gjithashtu, Blerësi do të zhdëmtojë dhe nuk do të bëjë përgjegjës Shitësin për çdo Pretendim, humbje, dëm, kosto, detyrim, shpenzim, pakësim në vlerë ose mungesë të çdo lloji, që rrjedhin nga ose në lidhje me ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve të Shitësit sipas kësaj Marrëveshjeje ose në bazë të Marrëveshjes së Koncesionit (në cilësinë e tij si Koncesionar), për sa i përket çdo hidrocentrali të energjisë hidro-elektrike në pronësi dhe/ose që shfrytëzohet nga KESH në rrjedhën e sipërme të Hidrocentralit; me kusht, megjithatë, që sa më sipër nuk do të zbatohet dhe Blerësi nuk do të zhdëmtojë ose do të bëjë përgjegjës Shitësin në lidhje me çdo neglizhencë, mashtrim ose veprim të papranueshëm të qëllimshëm, shkelje të kësaj Marrëveshjeje ose të Marrëveshjes së Koncesionit të kryera nga Shitësi (në cilësinë e tij si Koncesionar).

12.4. Shlyerjet/Kompensimet dhe Kundërpretendimet

Secila Palë do të ketë të drejtë të shlyejë/kompensojë çdo shumë të pagueshme, detyrim apo pretendim sipas apo në lidhje me këtë Marrëveshje mbi të gjitha shumat e pagueshme, detyrimet ose pretendimet e Palës tjetër sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje.

12.5. Gjuha

Kjo Marrëveshje do të nënshkruhet dhe zbatohet në gjuhën Angleze dhe Shitësi do të sigurojë një përkthim të saj në gjuhën Shqipe sa më shpejt të jetë e mundur pas nënshkrimit të saj. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, versioni i gjuhës Angleze do të ketë përparësi ndaj versionit në gjuhën Shqipe. Çdo komunikim dhe njoftim ndërmjet Palëve në lidhje me këtë Marrëveshje do të jetë në Anglisht ose Shqip (së bashku me përkthimin në Anglisht, kur është e mundur).

12.6. Ligji i Zbatueshëm

Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë

12.7. Njoftimet

Çdo njoftim ose komunikim tjetër nga njëra Palë te Pala tjetër, i cili kërkohet ose lejohet të bëhet sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje do të: (i) bëhet me shkrim; (ii) dërgohet personalisht (dorazi) ose dërgohet me anë të postës së regjistruar me parapagim ose me postë të shpejtë në adresën e Palës tjetër, e cila është paraqitur më poshtë ose në ndonjë adresë tjetër që Pala tjetër mund të kërkojë duke njoftuar, ose do të dërgohet me faks (me fletën konfirmuese të dërgimit) në numrin e faksit të Palës tjetër, i cili është paraqitur më poshtë ose në një numër tjetër faksi siç mund ta kërkojë duke e njoftuar Pala tjetër; dhe

(iii) shënohet në vëmendje të personit(ave) të përcaktuar më poshtë ose të personave të tjerë siç mund të kërkojë duke njoftuar Pala tjetër.

Çdo njoftim ose komunikim tjetër i bërë nga njëra Palë te tjetra në përputhje me dispozitat e mësipërme të këtij Neni do të konsiderohet se është marrë nga Pala tjetër, nëse është dërguar dorazi në ditën që është lënë te adresa e asaj Pale, nëse është dërguar me anë të postës së regjistruar me parapagim ose me postë të shpejtë dyzet e tetë orë (48) nga data e postimit, ose nëse është dërguar me faks, siç parashikohet më sipër.

Shitësi:

Österreichische Elektrizitätswirtschafts-Aktiengesellschaft

Am Hof 6A
1011 Vienna, Austria

Në vëmendje: Bordi i Administrimit
Fax +43 (0)50313 50069

dhe

Shoqëria e Projektit

[informacion që do të merret pas krijimit]

Blerësi:

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH)

Rruga "Vasil Shanto", Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje: Drejtorit të Përgjithshëm
Fax +355 4 2232046

12.8 Vlefshmëria e Marrëveshjes

Nëse ndonjë kusht ose dispozitë e kësaj Marrëveshjeje do të konsiderohet e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme, dispozitat e tjera të Marrëveshjes nuk do të preken dhe Palët do të kërkojnë tu japin efekt

kushteve apo dispozitave të sipërpërmendura nëpërmjet çdo mjeti tjetër të arsyeshëm dhe ligjor, duke përfshirë amendamentet e kësaj Marrëveshjeje.

12.9 Garanci e mëtejshme

Palët në çdo kohë do të kryejnë të gjitha veprimet e tjera dhe do të nënshkruajnë e dërgojnë këto akte dhe dokumente siç do të kërkohet në mënyrë të arsyeshme me qëllim që të përmbushin dhe zbatojnë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

12.10 Marrëveshja e plotë

Kjo Marrëveshje, duke përfshirë Deklarimin Hyrës dhe Shtojcat bashkëngjitur kësaj, përfaqëson marrëveshjen e plotë të lidhur ndërmjet Palëve në lidhje me Projektin e Hidrocentralit Ashta dhe zëvendëson secilën dhe të gjitha marrëveshjet ose rregullimet e mëparshme, qoftë verbale ose me shkrim, ndërmjet po këtyre Palëve në lidhje me këtë hidrocentral dhe me të gjithë përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë çdo marrëveshje ose shkëmbim informacioni në lidhje me tenderimin e Projektit).

12.11 Mos heqja dorë

Palët nuk do të konsiderohen se kanë hequr dorë nga ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, përveç kur një dorë heqje e tillë është bërë shprehimisht me shkrim. Mos-bërja e përpjekjeve nga secila prej Palëve për të përmbushur saktësisht secilën prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose për të përfituar nga ndonjë prej të drejtave të saj sipas saj nuk do të interpretohet si dorë heqje nga ndonjë dispozitë e tillë ose nga këto të drejta në të ardhmen.

Kjo Marrëveshje është nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar rregullisht të Palëve këtu, në datën, e shkruar më sipër.

KESH (KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE)

Nga: _____

Nga:

Emri: _____

Emri:

Titulli: _____
Titulli: _____

Österreichische Elektrizitätseirtschafts-Aktiengesellschaft

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

SHTOJCA I KËRKESAT MINIMALE PËR SISTEMET E MATJES

Kërkesat minimale të mëposhtme janë objekt i Kodit të Shpërndarjes, Kodit të Matjes Elektrike ose Kodit të Sistemit të Transmetimit:

Pajisjet e Matjes Hidraulike

Pajisjet e Matjes Hidraulike do të përbëhen nga sa më poshtë:

një instrument matës elektronik i ndodhur brenda një kafazi të palëvizshëm në Kanalin Hyrës për të matur nivelin e ujit në të me një saktësi prej +/- 40 milimetra; dhe

një instrument matës elektronik i ndodhur brenda një kafazi të palëvizshëm në Ujin Shkarkues për të matur nivelin e ujit në Ujin e Shkarkimit me një saktësi prej +/- 40 milimetra.

Pajisjet e Matjes Vizuale

Një pajisje e matjes vizuale do të vendoset në një kafaz të palëvizshëm në Kanalin e Hyrjes dhe në Kanalin e Daljes .

SCADA (Sistemi i Kontrollit dhe Përfitimit të të Dhënave)

Sistemi Kryesor i Matjes dhe Sistemi i Matjes së Kontrollit do të lidhen me Qendrën e Kontrollit SCADA dhe me Dhomën e Kontrollit SCADA .

Matësit e Prodhimit

Çdo Matës i Prodhimit do të regjistrojë kW dhe kWh si dhe MVar dhe MVarh. Kufijtë e saktësisë dhe kufijtë e lejuar të gabimeve të pajisjet matëse do të jenë sipas specifikimeve të Kodit të Matjes Elektrike.

Testimet

Testet Fillestare: Pajisjet Hidraulike të Matjes dhe Matësit e Prodhimit do të testohen për saktësinë pas prodhimit në laboratorë të çertifikuar të testimit. Transformatorët aktualë të tensionit do të testohen për gabimet në fuqinë dhe për këndin e fazës pas prodhimit në një laborator të çertifikuar të testimit. Çertifikatat e testimit të lëshuara nga struktura e testimit do të lëshohen në mënyrë të pavarur nga të dyja Palët. Secila nga Palët mund të marrë pjesë në testim me shpenzimet e veta. Konçesionari fillimisht do të testojë Pajisjet Hidraulike të Matjet dhe Matësit e Prodhimit për saktësinë e tyre; dhe jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pasi të jenë instaluar ose pas datës së vendosur për testimin fillestar të njësive së parë të Hidrocentralit.

Testet Vijues: Secila Palë do të testojë më pas saktësinë e Matësve të Prodhimit aq shpesh sa është specifikuar në Kodin e Matjes Elektrike dhe në

Pajisjet Hidraulike të Matjes, dhe do të testohen të paktën një herë çdo dy (2) vjet.

Riparimi, Zëvendësimi ose Ri-kalibrimi: Kur çdo element i Sistemit Kryesor të Matjes ose të Sistemit të Matjes së Kontrollit është jashtë kufijve të pranueshëm ose nuk funksionon në mënyrën e duhur, Pala që e ka në pronësi këtë matës, menjëherë do ta riparojë, ri-kalibrojë ose të zëvendësojë këtë element me shpenzimet e veta. Pas përfundimit të ekzaminimit, mirëmbajtjes, riparimit ose ri-kalibrimit, ose zëvendësimit të ndonjë elementi përbërës të sistemit matës, elementi në fjalë do të testohet sërish në një objekt të çertifikuar testimi.

Shënim: Secila Palë do t'i japë Palës tjetër një njoftim paraprak të paktën prej shtatë ditësh për çdo testim që do të kryhet. Palët që do të marrin njoftimin kanë të drejtë të kenë një përfaqësues të pranishëm në një testim të tillë, si dhe gjatë inspektimit të Sistemit Kryesor të Matjes dhe Sistemit të Matjes së Kontrollit, ose në çdo rregullim që ka të bëjë me to.

Vulosja

Matësit e Prodhimit dhe kabinat e Pajisjeve të Matjes Hidraulike duhet të vulosen së bashku. Përveç rasteve Emergjente, secila Palë do t'i japë Palës tjetër të paktën një njoftim paraprak prej njëzet e katër (24) orësh për prishjen e çdo vule. Çdo njoftim do të specifikojë kohën kur vula e matësit është thyer, dhe pala tjetër do të ketë të drejtë të ketë një Person të pranishëm në rast se një vulë e tillë rezulton e thyer.

Leximi

Brenda tolerancave të saktësisë: Nëse leximi i Sistemit Kryesor të Matjes dhe Sistemit të Kontrollit të Matjes në intervalet specifike është brenda tolerancave të saktësisë të përshkruara këtu, do të zbatohen dispozitat e mëposhtme:

Pajisjet e Hidraulike të Matjes dhe Matësit e Prodhimit duhet të jenë në gjendje të regjistrojnë çdo gjashtë sekonda;

Kapaciteti Prodhues për çdo orë duhet të llogaritet duke i shtuar leximet mesatare në kW të marrë në çdo Matës Prodhimi të Sistemit Kryesor të Matjes. Leximi mesatar në kW për çdo Matës Prodhimi do të përcaktohet duke i shtuar leximet në kW për Matësin e Prodhimit në gjashtë sekonda interval në atë orë dhe duke pjesëtuar me 600.

Kushtet Hidraulike për çdo orë do të llogariten duke mbledhur diferencat ndërmjet leximeve të Pajisjeve Hidraulike të Matjes dhe të Sistemit Kryesor të Matjes në gjashtë sekonda interval në atë orë dhe duke pjesëtuar me 600.

Matësit e Prodhimit: Nëse leximet e Matësit të Prodhimit variojnë nga njëri- tjetri më shumë se ç'kërkohet nga Kodi i Matjes Elektrike, çdo Palë do të kryejë testime shtesë të Matësit të Prodhimit në pronësi të tij.

Në këtë rast, për të llogaritur shumën e saktë, do të përdoren leximet e Matësit të Prodhimit që nuk janë të pasakta në vlera më të mëdha se ç'kërkohet nga Kodi i Matjes,

Nëse të dy Matësit e Prodhimit janë ta pasaktë në vlera më të mëdha se ç'kërkohet nga Kodi i Matjes, ose funksionojnë në mënyrë jo të saktë, Shitësi dhe KESH do të përgatisin një llogaritje të përafërt në bazë të të gjithë informacionit të disponuar.

Instrumentet e matjes së Nivelit të Ujit: Nëse leximet e Pajisjes Hidraulike të Matjes të Sistemit Kryesor të Matjes dhe të Sistemit të Kontrollit të Matjes variojnë me më shumë se 40 milimetra, çdo Palë do të kryejë testime shtesë të Pajisjeve Hidraulike të Matjes në pronësi të saj.

Në këtë rast, për të llogaritur Kushtet Hidraulike të sakta, do të përdoren leximet e instrumentit në pjesën e sipërme të Rezervuarit dhe Ujit Shkarkues të cilat rezultojnë se nuk janë të pasakta me më shumë se 40 milimetra .

Në rast se të dyja instrumentet si në pjesën e sipërme të Rezervuarit ashtu dhe në Ujit Shkarkues, janë të pasakta në më shumë se 40 milimetra ose funksionojnë në mënyrë jo të saktë, Shitësi dhe KESH do të përgatisin një llogaritje të përafërt në bazë të të gjithë informacionit të disponuar, duke përfshirë dhe leximin e instrumentit vizual.

Pasaktësia: Në rast se Palët janë të detyruara të përgatisin një llogaritje të përafërt për shkak të mosfunksionimit ose pasaktësisë së një matësi përtej kufijve të lejuar të tolerancës dhe për të cilat është rënë dakord, mosfunksionimi ose pasaktësia do të quhen se kanë filluar në një datë të ndërmjetme, midis datës kur matësi është verifikuar se funksionon keq ose se është i pasaktë dhe datës kur leximi i matësit të fundit është pranuar nga Palët si i saktë nëse periudha e mosfunksionimit ose pasaktësisë nuk mund të përcaktohet saktësisht. Megjithatë, në asnjë rast, këto rregullime nuk do të bëhen në një periudhë para datës në të cilën është bërë testimi i fundit i matësit dhe që rezulton i saktë brenda tolerancave të lejuara dhe që nuk funksionon në mënyrë të pasaktë.

SHTOJCA II
PRODHIMI I DEKLARUAR

Periudha m	Prodhimi i Deklaruar i Përkohshëm për kohëzgjatjen, shprehur në kWh/h			
	1	2		24
Nga __ në __				
Nga __ në __				
...				
Nga __ në __				

Kjo shtojcë do të amendohet nga Shitësi herë pas here.

SHTOJCA III
FORMA E GARANCISË BANKARE TË BLERËSIT

[Emri i Ofertuesit]
[Data]

Letra e Garancisë Nr.: []

Meqënëse ju keni lidhur një Marrëveshje të Shitjes së Energjisë Elektrike më datë 30 Shtator 2008 (“Marrëveshja e Shitjes së Energjisë”) me klientin tonë Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) (“Blerësi”):

Ne, [] (“Banka”), me anë të kësaj Letre Garancie marrim përsipër në mënyrë të pakushtëzuar dhe të pakthyeshme t’ju paguajmë çdo shumë deri në vlerën e 3,000,000 Euro (tre milionë) (“Shuma Maksimale”), në lidhje me detyrimet e Blerësit sipas Marrëveshjes së Shitblerjes dhe në përputhje me sa më poshtë:

Do t’ju paguajmë menjëherë pas kërkesës suaj me shkrim dhe pavarësisht çdo kundërshtimi nga Blerësi ose të çdo pale tjetër, këtë shumë ose shumat sipas kërkesës suaj deri në Shumën Maksimale;

Të gjitha pagesat e bëra pas kërkesës suaj do të jenë të plota, duke mos u bërë ndonjë zbritje nga pagesa, si në të tashmen ashtu edhe në të ardhmen, për pagimin e ndonjë takse, detyrimi, tatimi, pagese të detyrueshme, tarife, zbritje ose pagesa të mbajtura të çfarëdolloj natyre dhe të vendosura nga cilido;

Angazhimet e marra në këtë garanci përbëjnë detyrimet tona të drejtpërdrejta dhe thelbësore dhe janë të pakushtëzuara dhe të pakthyeshme. Nuk do të përjashtohemi nga ndonjë ose nga të gjitha këto detyrime për asnjë arsye të çfarëdolloj natyre ose shkaku, të tillë si ndryshimi në kushtet e kontratës ose zgjatjes së saj ose ndryshimit në qëllimin ose natyrën e punës që do të kryhet, ose ndonjë mosveprim ose veprim i kryer nga ju ose nga ndonjë palë e tretë e cila do të na përjashtonte ose shkarkonte nga detyrimi dhe përgjegjësitë e shprehura në këtë garanci;

Kjo garanci do të mbetet e vlefshme dhe në fuqi dhe me pasoja deri në mbarim të datës _____ muaji _____ i vitit _____ [dmth, një (1) vit nga data e lëshimit]; dhe

Kjo garanci do të rregullohet dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet dhe rregullat e Republikës së Shqipërisë dhe çdo mosmarrëveshje në lidhje me të do të zgjidhet nga gjykata kompetente shqiptare.

Banka

Nënshkruesi i autorizuar

SHTOJCA IV
DETYRIMI I TAKSËS SË JASHTËZAKONSHME
Llogaritje e thjeshtë (e përafërt)
(Neni 3.1.1)

Taksat aplikueshme në lidhje me Projektin	Taksat ekzistuese në Datën e Hyrjes në Fuqi	Baza e taksës së përlllogaritur paraprakisht që nga Data e Hyrjes në Fuqi (acc për të audituar llogaritë financiare t-1) në EUR	Niveli i taksës në % (nga Data e Hyrjes në Fuqi)	Kosto përlllogaritur paraprakisht e shumës totale të taksave	Barra e taksës (acc për të audituar llogaritë financiare t-1) në EUR
Tatimi mbi të ardhurat	X	100	10	10	15
Tatimi mbi prodhimet dhe shërbimet	X	40	10	4	4
Tatim mbi shitjet	X	20	20	4	4
Tarifë doganore	---				
Taksë mbi importet	X	400	0.25	1	1
Tatimi imbajtur në burim	X	40	2.5	1	2
Taksë mbi transaksionet e valutave të huaja	---				1
Akcizat	---				1
Tatim mbi pronën dhe licenca regjistrimi	X	50	2	1	2
Tarifë mjedisore	X	50	2	1	3
	---				2
					1
				22	36

Kostoja faktike e Taksave Përmbledhëse Vjetore:
EUR

EUR

36.0

Kostoja e Taksave Përmbledhëse Vjetore e llogaritur paraprakisht: t-1 : 22.0

Prej saj 125% :

-27.5

Detyrimi i Taksës së Jashtëzakonshme:

8.5

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 22.10.2008
Doli nga shtypi më 22.10.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2008

Çmimi 36 lekë